



Republika e Kosovës



Komuna Hani i Elezit

Nr. : 02/5834/2022

Data: 27.07.2022



RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

Hani i Elezit 2022

PËRMBAJTJA

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS	1
TAKIME:	3
bashkëpunimi.	3
PROJEKTET E HARTUARA:.....	5
ZYRA LIGJORE	7
ZYRA E PERSONELIT	9
ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM.....	11
ZYRA E PROKURIMIT	12
ZYRA PËR INFORMIM.....	16
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME	18
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA.....	19
DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTËR DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	24
DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT	30
DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE	35
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENTE	44
DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	49
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK.....	50

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS

Fillimi i vitit 2022, gjashtëmuji i parë i fillimit të një qeverisje ndryshe dhe me prioritetë të reja. Duke qenë ekzekutiv i ri komunal dhe funksiojmë me buxhetin e vitit të miratuar nga viti 2021, angazhimi dhe përkushtimi ynë ka sjell aktivitete të cilat nuk kanë qenë të planifikuara mirëpo kanë ardhur si shkak i angazhimit të të gjithë ekipës punuese.

Me një staf të ri politik ku përmbushim kriteret e barazisë gjinore 50/50, komuna jonë ka marrë iniciativën e parë në gjithëpërfshirjen në vendimmarrje të barabartë dhe pa dallime gjinore.

Vijimësi e punëve të mira fillojnë me dekorimin e qytetit për festën e fundvitit dhe dekorimin e xhamive për Muajin e Shenjtë të Ramazanit, iniciativë kjo e cila largon edhe barrierat religjioze.

Gjatë këtij gjashtëmuji vërehet afërsia institucionale dhe bashkëkoordinimit të punëve me autoritetet lokale brenda Hanit të Elezit.

Organizimi i trajnimeve për rritjen e performancës brenda stafit komunal dhe avokimi për çështje aktuale në komunitetin tonë është gjë me të cilën mburremi për ofrimin e shërbimeve administrative sa më efikas.

TAKIME:

- Takim me shoqaten HandiKos.
- Komuna e Hanit të Elezit dhe Caritas-i Zvicerian thellojnë bashkëpunimin duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.
- Vizita e Kryetarit të Hanit të Elezit , z.Mehmet Ballazhi dhe një pjese të stafit në fabrikën për prodhimin e cimentos “Efkarpia Titan Group” dhe në Shkollën Bujqësore Amerikane në Selanik të Greqisë. - Takim me përfaqësuesit e Zyrës Rajonale të OSBE-së së Gjilanit.
- Takim pune z.Stefan Mager menaxher i projektit GIZ-SMS, z.Lulzim Baumman këshilltar i Ministrit të MMPHI (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë) për çështje mjedisore, znj.Vjollca Behluli nga GIZ-SMS, z.Muhamet Malsiu drejtor i DMMU (Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave) dhe znj.Drita Binaj nga GIZ.
- Takim me Ministrin e Zhvillimit Rajonal (MZHR-së) z.Fikrim Damka me bashkëpunëtorët e tij.
- Takim pune z.Visar Ganiu, Kryetar i Komunës Çair të Shkupit.
- Takim me Ambasadoren e Maqedonisë së Veriut në Kosovë, znj. Shpresa Jusufi.
- Takim me nj.Luljeta Limani Sylejmani–e graduar si major dhe drejtoreshë në Drejtorinë e Menaxhimit të Objekteve, z.Nuhi Dema–komandant i Stacionit Policor në Han të Elezit, si dhe z.Blerim Mustafa–arkitekt.
- Takim me , z.Recep Küdsün–Koordinator i Qendrës Kulturore të Kosovës

- Takim me Drejtoreshën e YARL, znj.Kosovare Sadiku dhe Asistenten e Projekteve, njëherit mentoren znj.Leunita Syla.
- Takim me znj.Florentina Hajdari Hajra - koordinatorë M4Y, znj.Mimoza Morina - monitoruese dhe vlerësuese e programit, znj.Arlinda Koshi - specialiste e ngritjes së kapaciteteve dhe znj.Fatmire Berisha - koordinatorë e Komponentit 1.
- Takim me z.Ray Nayler–zv.drejtorin për Marrëdhënie me Publikun në Ambasadën Amerikane, Besim Kokollari–specialist për Marrëdhënie me Publikun, si dhe znj.Rina Musa–koordinatorë për Rininë.
- Takim me znj.Ganimete Gërbovci –Udhëheqëse e Divizionit për Parandalim dhe Reintegrim të Personave të Radikalizuar, si dhe z.Esat Aliçkaj – Asistent Rajonal për Reintegrim nga organizata IOM.
- Takim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) së bashku me znj.Gentiana Pallaska–Këshilltare e Ministrit për Investime Kapitale, z.Refki Osmani–Menaxher i projekteve në MKRS, si dhe znj.Vlora Jahaj–arkitekte në MKRS.
- Takim për lansimin e projektit "Çmimi Evropian i Qeverisjes së Shkëlqyer (ELoGE) në Kosovë".
- Takim me z.Gelor Shala, kryeshefin ekzekutiv të Hekurudhave të Kosovës – TrainKos Sh.A, si dhe udhëheqësit ekzekutiv të Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës – Sh.A. Infrakos, z.Zymer Zekaj.
- Takim me "T.C. Vakıflar Genel Müdürlüğü".
- Takim për "Karta për Komunën e gjelbër dhe të qëndrueshme".
- Takim me Ministrinë e Ministri i Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit, z.Elbert Krasniqi.
- Vizitë nga zv.Ministri i Infrastrukturës, z.Hysen Durmishi.
- Vizitë studimore në Turqi me Asociacionin e Komunave të Kosovës.
- Vizita e Shefit të Misionit të OSBE-së për Kosovën, z.Michael Davenport në Han të Elezit.
- Takim me z.Nuhi Neziri, Kryetar i Komunës së Tearcës (Republika e Maqedonis së Veriut) me bashkëpunëtorët z.Atmir Luma, Shef i Kabinetit dhe z. Besim Imeri, Udhëheqës i Departamentit për Zhvillim Ekonomik Lokal.

Gjithashtu Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, pret çdo ditë qytetarë të cilët duan të diskutojnë me të për çështje të ndryshme.

MARRËVESHJE:

1. Marrëveshje me Komandën e Jugut për aktin e donacionit të furnizimit me panele solare pranë komunës së Hanit të Elezit,
2. Komuna e Hanit të Elezit nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Organizatën Kosovare për Talent dhe Arsim – TOKA,
3. Marrëveshje për shërbime të ujësjellsit dhe ujërave të ndotura në mes të Komunës së Hanit të Elezit dhe KRU "Bifurkacioni" SH.A,
4. Marrëveshje për depozitimin e mbetjeve inerte të krijuara nga Komuna Hani i Elezit si një material i mbushjes së pasme në guroren e Dimcës,

5. Memorandum Bashkëpunimi mes Komunës Hani i Elezit dhe komunës shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Komunës së Tearcës,
6. Memorandum bashkëpunimi Komuna Hani i Elezit me organizatë YIHR KS,
7. Marrëveshje bashkëpunimi Komuna e Hanit të Elezit dhe Caritas-i Zvicerian për projektin “Ndikimi i Rinisë në Mjedis” (YENI),
8. Marrëveshje bashkëfinancimi ndërmjet Komunës së Hanit të Elezit dhe MAPL,
9. Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Komunës Hani i Elezit dhe Universitetit të Shkencave të Aplikuara, Ferizaj,
10. Marrëveshja mes Komunës Hani i Elezit dhe Qeverisë së Kosovës për “Kartën e Gjelbërt”,
11. Marrëveshje bashkëpunimi mes Komunës Hani i Elezit dhe Illyrian shpk për platformën digjitale eShkollori.

PROJEKTET E HARTUARA:

1. Hartimi i projektit të rrugës Krivenik-Gorancë,
2. Projekti i fazës finale të Qendrës Kulturore të Rinisë,
3. Projekti i asfaltimit të rrugës Ramuka-Paldenicë,
4. Projekti i kanalit të hapur në fshatin Paldenicë (IPA fondet),
5. Projekti i mureve mbrojtëse,
6. Projekti i Parkut të Qytetit,
7. Projekti i rregullimit të hapësirave përreth Komunës,
8. Projekti i urës shtesë të ura e Seqishtës,
9. Projekti i vendosjes së ashensorit në objektin e Komunës,
10. Projekti i shtrimit me kubëza të rrugicave në zonat urbane dhe rurale etj.

Kryetari i Komunës

Mehmet Ballazhi

ZYRA LIGJORE

Zyra ligjore është e radhitur në organogramin e komunës në zyrën e Kryetarit të Komunës, e cila gjatë gjashtëmujorit të vitit 2022 ka vazhduar punët dhe detyrat në bazë të përshkrimit të detyrave të punës dhe udhëzimeve të tjera nga ana e eprorit, përkatësisht nga Kryetari i Komunës dhe gjithashtu bashkëpunimin me drejtorët/et e drejtorive dhe me zyrtarë të tjerë. Si zyrë kemi bashkëpunuar me të gjithë sektorët e Komunës dhe kemi arritur që pajtueshmëria e akteve të Komunës të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Shkurtimisht do të paraqesim numrin e akteve juridike të përpiluara gjatë gjysmë vitit të dytë të 2022. Në këtë zyrë gjatë periudhës së raportimit, janë përpiluar akte juridike të cilat do t'i shënojmë në tabelën e mëposhtme dhe do t'i krahasojmë me gjysmëvitin e kaluar:

Viti	Vendime	Përgjigje ne kërkesa	Përgjigje në padi	Autorizime	Njoftime	Vërtetime	Rekomandime	Kërkesat në inst. qendrore	Kontratë mbi shërbimin	Përgjigje ne kërkesë	auditorve
2021	88	10	07	12	2	1	0	1	0	1	
2022	92	12	65	20	3	2	3	3	0	1	
Dif.	+4	+2	+58	+8	+1	+1	+3	+2	0		

Duke pasur parasysh pozitën dhe detyrat e zyrës ligjore të gjitha aktet juridike të lartshënuara kanë qenë të hartuara dhe të mbështetura në dispozitat e aplikueshme të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Kuvendi i komunës së Hanit të Elezit gjatë gjysmë vitit 2022 ka miratuar vendime, akte juridike brenda fushës së kompetencës së tij të cilat do t'i paraqesim sipas muajve vijues dhe do t'a bëjmë krahasim me gjysmë vitin 2021, duke i specifikuar vendimet dhe rregulloret.

Muaji	Janar		Shkurt		Mars		Prill		Maj		Qershor	
Viti	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021
Vendime	4	6	6	5	2	-	3	2		4	6	1
Rregullore							1				1	

Nga kjo tabelë rezulton se gjatë gjysmë vitit 2021 gjashtëmujori i parë nga kuvendi i komunës së Hanit të Elezit janë miratuar gjithsej: 18 vendime, ndërsa në gjysmë vitin 2022 të gjashtëmujorit të parë janë miratuar 25 vendime dhe një Rregullore, pra janë miratuar 7 vendime më shumë se në vitin 2021 dhe 1 Rregullore.

Sa i përket vendimeve të miratuara, Zyra Ligjore prej muajit janar të vitit 2022 deri në muajin që po raportojmë në afatin e paraparë ligjor ka përcjellur të gjitha vendimet dhe rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës së

Hanit të Elezit me shkresë përcjellëse në MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për shqyrtim të ligjshmërisë), të parapara sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, vendimet janë cilësuar me efekt të plotë juridik dhe nuk kanë qenë në kundërshtim me legjislacionin, (këtu duhet të ceket se MAPL nuk ka përcjellë konfirmimet për të gjitha aktet tona të miratuara, por vetëm për disa që kanë qenë në kompetencë të tyre).

Zyra Ligjore përveç çështjeve juridike të sipërpërmendura merret edhe me përfaqësime juridike në Gjykata.

Gjatë periudhës së raportimit në komunën e Hanit të Elezit ka pasur padi të ndryshme, por më shumë kemi padi për vërtetim të pronësisë, si zyrë ju kemi bërë përgjigje në padi dhe kemi përfaqësuar komunën në Gjykata. Gjithashtu pas marrjes së aktgjykimeve në shkallën e parë të gjykatës kemi bërë ankesa në gjykatën e shkallës së dytë. Vlen të theksohet se nga gjykata e shkallës së dytë janë prishur një numër i konsiderueshëm i aktgjykimeve.

Për të gjitha llojet e padive duke respektuar Ligjin për procedurën kontestimore kemi bërë prapësime procedurale me përgjigje në padi në afatin ligjor, përfaqësimin e tyre me autorizim nga ana e Kryetarit të Komunës sipas ftesave të Gjykatës.

Vlen të theksohet se për shkak të mos zbatimeve të vendimeve administrative, pas plotfuqishmërisë së tyre debitorëve kemi bërë propozim për përmbarimin e vendimeve përmes përmbaruesit privat.

Zyra Ligjore ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe atë të Administratës Publike, në fushën e ligjshmërisë të akteve ligjore dhe nënligjore.

Kjo zyrë ka bërë pajtueshmërinë e akteve ligjore në Komunë nëpër sektorë dhe kemi dhënë disa komentime lidhur me dispozitat e Ligjeve, Rregulloreve apo Udhëzimeve Administrative.

Kemi pasur dy punëtori me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe me OSBE, ku unë jam edhe kryesues i Kolegjiut të Zyreve Ligjore, e ku janë trajtuar projekt ligje, udhëzime administrative dhe rregullore të ndryshme.

Udhëheqës i Zyrës Ligjore

Bajrush Laçi

ZYRA E PERSONELIT

Në Zyrën e Personelit gjatë periudhës janar-qershor 2022 janë kryer disa aktivitete, duke filluar nga mirëmbajtja e dosjeve, menaxhimi i pushimeve vjetore dhe pushimeve tjera, kërkesat dhe shkresat përcjellëse Ministrisë së Administratës Publike dhe institucioneve tjera, bashkëpunimi me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, njoftimin e punëtorëve rreth pushimeve dhe festave zyrtare, ndjekjen e trajnimeve, zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publik.

Janë kompletuar dosjet e pushimit vjetor për vitin 2021.

Gjithashtu sipas evidencës që posedon Zyra e Personelit dhe me kërkesë të vetë nëpunësve janë lëshuar:

- 4 vërtetime për marrdhënie pune,
- 4 vendime për mëditje jashtë vendit,
- 1 vendim për njohjen e përvojës së punës,
- 1 vendim për transferimin dhe sistemimin e nëpunësve në listë të pagave,
- 2 vendime për caktimin e detyrave shtesë,
- 2 vendime për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil,
- 1 vendim për pushim prindëror,
- 1 vendim për plotësim ndryshimin e Komisionit të Ankesave,
- 1 përgjigje në ankesë për kandidatin në procedurë rekrutimi për arsim,
- 3 përgjigje në ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil,
- 1 përgjigje në kërkesë për vërtetim të marrëdhënies së punës,
- 1 përgjigje lidhur me punën praktike të studentëve për Drejtorinë e Administratës,
- 1 përgjigje për Auditorin,
- 2 përgjigje për nëpunësen Vjosa Rogaqi,
- 3 shkresa përcjellëse për Komisionin e Ankesave.

Është përgaditur plani vjetor i trajnimeve dhe i njëjti është përcjellur në MAPL, gjithashtu në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme dhe me përkrahjen e ASHI-së është funksionalizuar Sistemi i Vijueshmërisë në Punë.

Me kërkesë të Zyrës së Personelit, i gjithë stafi i Administratës është pajisur me Kartela Identifikuese me të cilat bëhet edhe evidentimi i vijueshmërisë së punës në sistem, i cili menaxhohet nga mbikqyrësit e drejtpërdrejt dhe monitorohet nga Zyra e Personelit.

Zyra e Personelit gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore ka zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit në nivel të Komunës duke përfshirë edhe rekrutimet në Arsim dhe Shëndetësi.

Procedura të zhvilluara në sektorin e Arsimit janë gjithsej 10:

- 2 procedura Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta,
- 2 procedura për TIK,
- 1 procedurë Gjuhë Gjermane,
- 1 procedurë Gjuhë Shqipe,
- 3 procedura për Mësim Klasor,

- 1 procedurë për Fizikë,

Procedura të zhvilluara në sektorin e Shëndetësisë janë gjithsej 2:

- 1 Infermier në QKMF dhe □ 1 Mjek të Mjekësisë Familjare.

Procedura të zhvilluara në Administratë përmes Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore janë gjithsej 4:

- Zyrtar për Bujqësi (i dështuar),
- Zyrtar për Tatimin në Pronë (i dështuar),
- Zyrtar për Emergjencë (i dështuar), si dhe
- Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim (duke u zhvilluar procedura).

Janë vazhduar kontratat e punës për punëtorët teknik.

Nga sistemi i “Payroll” janë shkarkuar listat e pagave të cilat përcillen në drejtoritë përkatëse për tu nënshkruar dhe kthehen përsëri në Zyrën e Personelit ku arkivohen.

Gjithashtu në bashkëpunim me drejtorët/et e drejtorive janë caktuar nëpunësit të cilët kanë ndjekur trajnime në Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe nga disa organizata tjera joqeveritare.

Janë përgatitur aktet e emërimit për stafin mbështetës në Zyrën e Kryetarit.

Punë sistematike në Zyrën e Personelit është vendosja e nëpunësve të ri dhe largimi i të punësuarve që u përfundon marrëdhënia e punës në Sistemin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Udhëheqëse e Personelit

Ajete Berisha - Duraj

ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Gjatë gjashtëmuajorit të parë 2022 nuk kemi pasur kërkesa për raste të personave të riatdhesuar.

Gjatë periudhës Janar-Qershor në zyrën për Komunitete dhe Kthim ka pasur (14) kërkesa për vërtetim për të paraqitur te Zyra e Punësimit.

Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar **(14)** vërtetime për aplikim në Zyrën e Punësimit për mbështetje nga programi i riintegritimit dhe për plan-biznese individuale.

Nga 14 kërkesat e paraqitura në Zyrën e Punësimit, të gjithë aplikuesit janë përfitues, nga të cilët trajnim në punë janë 5 përfitues dhe vetëpunësim janë nëntë persona të Organizatës UNDP, në bashkëpunim me MPB-në.

Gjatë vitit 2022 kam pasur edhe trajnim në tryezën e rrumbullakët për zhvillimin e planeve komunale të veprimit për ri-integrimin 2023-2025.

Zyrtar i Zyrës për Komunitete dhe Kthim

Xhemshit Kalisi

ZYRA E PROKURIMIT

Zyra e Prokurimit gjatë muajve Janar-Qershor ka zhvilluar aktivitete duke u bazuar në Ligjet për Prokurim Publik Nr. 04/L-042, LIGJI Nr. 05/068: dhe LIGJI Nr. 05/L-092, dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP).

Zyra e Prokurimit gjatë këtij gjashtëmujori ka zhvilluar aktivitete të tenderimit duke përgatitur lëndë dhe pagesa dhe duke i dërguar në Zyrën për Financa.

Me ligjin në fuqi për çdo procedurë i drejtohem KRPP-së për sqarime dhe që i raportojmë vazhdimisht KRPP-së për aktivitetet tona dhe çdo aktivitet shpallet në faqen e KRPP-së.

Zyra e Prokurimit ka zhvilluar këto lloje të procedurave:

Procedura me vlera minimale mbi 100.00 € dhe më pak se 1,000.00 €

Procedura me vlera të vogla (1,000.00 € deri 10,000.00 €) dhe të mesme (mbi 10,000.00 €)

Procedura me vlera të vogla dhe të mesme vlerat mbi 1,000.00 € dhe më pak se 100,000.00 € (furnizime & shërbim & punë).

Procedurat që janë zhvilluar për prokurimet mbi 1,000.00 € janë:

Nr.	Përshkrimi i projektit	Data e shpalljes së ofertës	Data e nënshkrimit të kontratës	Shuma e planifikuar	Shuma e projektit	Operatori fitues
1.	Shërbime të byfes komunale për nevoja të Zyrës së Kryetarit, drejtorive, Kuvendit Komunal dhe zyrtarëve	13.01.2022	18.03.2022	€ 9,998.00	€ 9,630.60	NT. ATLLAS
2	Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës - vazhdimi i fazës së dytë - punët finale	01.02.2022	22.03.2022	€ 268,330.00	€ 267,552.00	ATC COM; WORLD MEDIUM
3	Mirëmbajtja e ndriçimit publik në zonën urbane dhe rurale	09.03.2022	01.04.2022	€ 9,966.80	€ 8,852.50	ELEKTRA
5	Punimi i tavanit të varur te QKMF-ja	17.03.2022	06.05.2022	€ 9,962.00	€ 8,455.00	Arhiko.Ing
5	Digjitalizimi i shkollave	Në procedurë	DKA			
6	Punimi i ndriçimit publik	Në procedurë				

7	Furnizim me material zyrtar dhe shtypi jashtë listës së AQP-së	07.04.2022	26.05.2022	€ 16,000.00	€ 14,898.64	Star Graf SHPK
8	Zhbllokimi i gypave të kanalizimit	07.04.2022	06.05.2022	€ 9,976.00	€ 9,804.00	EURO PLUS SHPK

9	Servisimi i RTG te QKMF-së	15.04.2022	17.05.2022	€ 3,260.00	€ 3,260.00	LEDI-MED SHPK
10	Minitender - Furnizim me kompjuter	19.04.2022	24.05.2022	€ 15,200.00	€ 15,068.00	ARITECH SHPK
11	Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në Han të Elezit	18.04.2022	26.05.2022	€ 9,980.00	€ 5,497.50	Limit L&B shpk
12	Furnizim me material higjienik për institucionet e Hanit të Elezit	29.04.2022	27.05.2022	€ 9,994.00	€ 6,751.60	PM Group SHPK
13	Asgjësimi i barnave me afat të skaduar	17.06.2022	Në procedurë			
14	Furnizimi dhe vendosja e tabelave digjitale në “Rr.Adem Jashari” - Hani i Elezit	11.05.2022	22.06.2022	€ 20,000.00	€ 18,599.20	KROSA traffic sings SHPK
15	Gjelbërimi i disa hapësirave publike	16.05.2022	Ne procedure	€ 22,987.25	€ 18,015.80	Murseli
16	Furnizimi dhe montimi i dy reklamave 3D	19.05.2022	16.06.2022	€ 3,790.00	€ 1,889.30	KROSA
17	Minitender - Pemë dhe perime	09.06.2022	24.06.2022	€ 2,767.00	€ 2,766.72	SKANDI & Doni Produkt
18	Furnizim me dru për institucionet	Anulohet aktiviteti	Për shkak të çmimit të shtrenjtë të ofertave			
19	Rregullimi i parkut “Isa Berisha”	26.05.2022	Në procedurë të vlerësimit			
21	Akomodimi, ushqimi dhe transporti i asambleistëve në Shqipëri	07.06.2022	24.06.2022	4,538.00 €	4,460.00 €	Arditi Tours
22	Furnizim me regjistrator dhe letër për Komunën	15.06.2022	Në porocedurë			

Procedurat nën 1,000 €

Procedurat që janë zhvilluar për prokurimet mbi 1,000.00 € janë:

Nr.	Përshkrimi i projektit	Data e shpalljes së ofertës	Data e kontratës	Shuma e planifikuar	Shuma e projektit	Operatori fitues
1.	Shërbime konsulente të arkitekturës për nevoja të Zyrës së Urbanizmit	31.03.2022	12.04.2022	€ 860.00	€ 860.00	Adnan Lusnjani
2	Shërbime konsulente (arsimtar) të Gjuhës Gjermane	04.04.2022	15.04.2022	€ 990.00	€ 990.00	Semia Berisha
3	Zgjerimi i rrjetit të internetit brenda objektit të Komunës	06.04.2022	15.04.2022	€ 990.50	€ 865.95	Goni Computers
4	Furnizim me material të IT-së	07.04.2022	08.04.2022	€ 993.50	€ 943.50	Goni Computers
5	Shërbime kontraktuese mësimdhënëse për TIK	11.04.2022	15.04.2022	€ 990.00	€ 990.00	Hanushe Dernjani
6	Furnizim me notesa, mirënjohje dhe kimika me mbishkrim - Komuna Hani i Elezit	19.04.2022	22.04.2022	€ 995.00	€ 990.00	Muhamet Dernjani B.I
7	Mirëmbajtja e shportave të mbeturinave, ulëseve nëpër qytet	21.04.2022	16.04.2022	€ 999.00	€ 995.00	Zija Shkreta B.I
8	Servisimi i veturës së Kryetarit KIA SPORTAGE	26.04.2022	10.05.2022	€ 998.00	€ 930.36	AGS (Ideal Shala B.I)
9	Servisimi i veturave Hyundai i20 & i35	12.05.2022	17.05.2022	€ 995.00	€ 657.00	Hyundai Auto shpk
10	Hartimi i projekteve të mureve mbrojtëse në Rr.Veteranët e UÇK-së	11.05.2022	16.05.2022	€ 990.00	€ 987.00	Studio Hapesira shpk
11	Furnizim me material sportiv për javën kulturore	26.05.2022	03.06.2022	€ 994.50	€ 981.00	Vlera Sport ltd SHPK
12	Hartimi i projektit - Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatra	01.06.2022	16.06.2022	€ 996.15	€ 992.80	Studio Hapesira shpk

13	Furnizim me një klimë për nevoja të SHML Dardania - Hani i Elezit	17.06.2022	29.06.2022	€ 920.00	€ 915.00	Termovision shpk
----	---	------------	------------	----------	----------	------------------

P.S. Procedurat në proces janë procedura që janë duke u zhvilluar dhe nuk është përfunduar procedura e prokurimit për ato aktivitete.

Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit
z. Xhevdet Bushi

ZYRA PËR INFORMIM

Zyra e Transparencës në përputhje me planin e aprovuar të veprimit për vitin 2022, aktivitetin e vet e ka zhvilluar në kryerjen obligimeve në fushën e informimit publik sa më të mirë, si të qytetarëve të Komunës ashtu edhe opinionin sa më të gjerë për të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me zhvillimet në Komunën tonë.

Zyra e Transparencës punën e saj e mbështetë nga obligimet që dalin në bazë të dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr. 04/20018 për Transparencën në Komuna, të dispozitave të UA 05/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit me Publikun të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe LIGJI NR. 03/L215 për Qasje në Dokumente Publike, si dhe të dispozitave të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit.

Në vazhden e aktiviteteve që kanë dalë nga këto obligime, Zyra e Transparencës ka bërë informimet dhe njoftimet me kohë që dalin si obligime ligjore nga Rregullorja për Transparencë, njoftimet me kohë për debate publike tematike, në të cilën janë propozuar për debat dokumentet e dala nga Kuvendi i Komunës.

Zyra e transparencës ka informuar me kohë lidhur me aktivitetet e organeve të Komunës së Hanit të Elezit duke raportuar mbi aktivitetet e Kryetarit të Komunës dhe ekzekutivit, punën e Kuvendit të Komunës dhe trupave të saja, si dhe aktiviteteve tjera të cilat kanë qenë me interes publik.

Gjatë këtij gjashtëmujori, në Komunën e Hanit të Elezit ka pasur shumë ngjarje dhe zhvillime të cilat Zyra e Informimit ju ka prezantuar qytetarëve të Komunës sonë, por edhe opinionit më të gjerë me informatat në faqen zyrtare në rrjetet sociale - Facebook.

Në web-faqen zyrtare të Komunës <https://kk.rks-gov.net/haniielezit/> janë realizuar këto aktivitete:

- Inçizimi dhe publikimi i të gjitha mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,
- Publikimi i aktiviteteve të rregullta të komiteteve obligative,
- Janë publikuar me kohë dhe me rregull të gjitha procedurat e prokurimit publik,
- Janë publikuar me kohë të gjitha procedurat e konkurseve,
- Vendimet e Kuvendit të Komunës,
- Si dhe informatat të rregullta me interes për publikun.

Faqja zyrtare e Komunës së Hanit të Elezit është plotësisht funksionale dhe rregullisht e përditësuar me të dhëna dhe informata, përkundër shumë pengesave në mirëmbajtjen nga ana e MAP.

Në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike 03/L-215 dhe udhëzimeve administrative përcjellëse, Zyra për Informim është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe raportimin periodik të zbatimit të këtij Ligji.

Gjatë këtij gjashtëmujori, Komuna e Hanit të Elezit ka pasur 10 kërkesa për qasje në dokumente publike të cilat kanë marrë përgjigjeje në afatet e parapara ligjore.

Në fushën e teknologjisë informative, Zyra e Transparencës është angazhuar në mirëmbajtjen dhe funksionimit të pajisjeve, sistemeve dhe aplikacioneve teknike për zbatimin në realizimin e projekteve në kuadër të ekeverisjes. Sistemi i TI-së ka qenë funksional, aplikacionet funksionale si dhe zyrtarët dhe qytetarët për as një moment nuk kanë mbetur pa shërbimet e nevojshme.

Qendra për Punë Sociale, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, si dhe Zyrës për Shërbimin e Pensionistëve, kanë qenë të kyqura pa pengesa në sistemin e intranetit të komunës, që ka mundësuar që zyrtarët të kryejnë shërbimet për qytetarë përmes aplikacioneve përkatëse.

Gjatë këtij gjashtëmujori, nga buxheti i Komunës nuk ka pas shpenzime të mjeteve buxhetore për mirëmbajtje të sistemit të TI-së, ndërsa janë realizuar furnizime në pajisje për të cilat janë vlerësuar si të nevojshme.

Gjatë kësaj periudhe kohore, kam marrë pjesë në takime zyrtare dhe punëtori për të cilat është vlerësuar se janë në interes të ngritjes së kapacitetit, si dhe në interes të prezentimit të Komunës.

Si anëtar i grupit punues për Sistemin e Menaxhimit të Performacës, kam plotësuar të dhënat për dy fusha të këtij sistemi:

-Administrata Komunale

-Transparenca Komunale

Zyrtar i Transparencës

Bashkim Sopa

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2022 ka qenë e përkushtuar për miratimin dhe funksionimin e rregullt të sistemit Intranet, ku procesohen kërkesat/ankesat dhe shërbime të tjera me qytetarët.

Kemi pasur efikasitet në shërbimet e gjendjes civile me kërkesat e qytetarëve.

Vendosja e pajisjes për Sistemin e Vijueshmërisë në Punë në bashkëpunim me ASHI-në në kuadër të ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Zgjerimi i rrjetit brenda Komunës për lehtësim të qasjes së zyrtarëve komunal në rrjet të ofruar nga Komuna.

Janë zgjedhur bashkësitë lokale në Komunën e Hanit të Elezit në të gjitha lokalitetet, sipas Rregullores për organizimin e këshillave të fshatrave.

Ka filluar transmetimi i seancave live të Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit dhe gjithashtu po përmbushim kriter të transparencës komunale.

Funksionalizimi i fibrës optike (back-up) përmes MAPL-së.

Pjesëmarrje nëpër trajnime, seminare e konferenca, të cilat prekin drejtpërdrejt interesin e Administratës së Përgjithshme për sjelljen e aktiviteteve të reja.

QENDRA PËR SHËRBIM ME QYTETARË:

- Janë regjistruar 4851 lëndë nëpër drejtori përkatëse.

GJENDJA CIVILE:

- Janë lëshuar 3182 certifikata të llojeve të ndryshme në bazë të kërkesave përkatëse të qytetarëve.

DEPO:

- Janë regjistruar 102 kërkesa për furnizim nga depoja komunale dhe janë regjistruar 16 kërkesa për furnizimin e depos.

AUTOPARKU:

- Janë regjistruar 294 kërkesa, ndërsa janë llogaritur 52626 km të kaluara dhe furnizim me karburante janë 4216 litra.

SEKTORI I KUVENDIT:

- Kuvendi Komunal ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta, 2 mbledhje solemne.
- Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta.
- Komiteti për Komitetet ka mbajtur 6 mbledhje.
- Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuar ka mbajtur 3 mbledhje.
- Janë hartuar 15 procesverbale për Kuvendin Komunal të Komunës së Hanit të Elezit.
- Janë bërë 26 vendime të ndryshme. **ARKIVA:**
- Numri i lëndëve të arkivuara janë 847 lëndë.

Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për periudhën janar – qershor 2022, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësi, në periudhën Janar – Qershor 2022 ka funksionuar kryesisht në tre (3) sektorë: 1. Sektori për buxhet dhe financa,

2. Sektori për të hyrat dhe 3.

Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej shtatë (7) zyrtarëve, gjatë kësaj periudhe kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore, me qëllimin kryesor që të bëjmë një prezentim sa më gjithëpërfshirës të punëve dhe aktiviteteve të zhvilluara gjatë kësaj periudhe, në vazhdim me prioritet mbi të gjitha do të veçojmë:

1. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

Ky sektor ka kryer këto aktivitete:

- Përpilimi dhe përgatitja e rrjedhës së parasë së gatshme për të gjitha programet dhe nën-programet buxhetore, me zotimet dhe shpenzimet e parashikuara të mjeteve buxhetore sipas dinamikës së planifikuar për periudhën gjashtëmujore 2022, nëpër të gjitha kategoritë ekonomike, si: Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale, Subvencione e Transfere dhe Investime Kapitale.
- Përgatitja e propozim-vendimit për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake 2020 dhe 2021 në vitin vijues 2022, në shumë prej **72,737.76 €**.
- Përgatitja e vendimit për transferin e mjeteve nga kategoria Rezerva në kategorinë Investime Kapitale në vlerë prej 15,000.00 €.
- Përgatitja e raportit final të konsoliduar dhe analitik të bilancit të gjendjes për vitin 2021 dhe publikimi i tyre në ueb-faqen e Komunës.
- Përgatitja dhe hartimi i raporteve tremujore për ekzekutimin e buxhetit për periudhat: janar - mars 2022.
- Përgatitja dhe hartimi i raporteve mujore (janar-qershor) të buxhetit sipas drejtorive, sipas kategorive të shpenzimeve dhe publikimi i tyre në ueb-faqe të Komunës.
- Përgatitja e pasqyrave financiare për vitin 2021 dhe përcjellja e raportit për Ministri të Financave Departament të Thesarit.

- Gjatë muajit Prill kemi pasur auditimin e jashtëm për vitin 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe e kemi pranuar raportin final të auditimit.
- Është publikuar raporti final i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2021 në ueb faqe të Komunës.
- Mbajtja e tri debateve publike me qytetarët me datën 24.06.2022 në 3 lokacione, që kishte të bëjë me Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për periudhën afatmesme 2023-2025.
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitet 2023-2025, ky dokument zhvillimor i miratuar në Kuvend Komunal me datën 30.06.2022, është dërguar në Ministri të Financave dhe publikuar në ueb-faqe të Komunës.
- Përgatitja e raporteve për barazim me thesarin për vitin 2022, si dhe raportin për periudhën janar-qershor të shpenzimeve për vitin 2022.
- Përgatitja e nën-alokimeve të nën-programet e shkollave nëpër kategoritë ekonomike: Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale.
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuara për pagesën e pagave dhe shtesave, të këshilltarëve komunal, komiteteve të ndryshme të kuvendit, të sektorit të arsimit dhe sektorit të kujdesit primar shëndetësor.
- Ekzekutimi i shujtave të mësimdhënësve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive për vitet 2018, 2019 dhe 2020.
- Ekzekutimi i pagave Jubilarë në kuadër të Arsimit dhe Shëndetësisë.

Në këtë periudhë raportuese janar - qershor 2022, nga të gjitha programet dhe nën-programet buxhetore sipas kërkesave të parashtruara janë iniciuar procedurat duke u bërë zotimi i mjeteve në 523 urdhër zotimi për pagesa (UZP), pastaj është vazhduar me procedimin e tyre në formë të shpenzimeve dhe aprovimi i të gjitha shpenzimeve për të gjitha kërkesat e parashtruara dhe vendimet e marra për shpenzime, prej të cilave përfundimisht me gjendjen e datës 30.06.2022, janë ekzekutuar në total 530 pagesa, ku shuma e mjeteve është në lartësi prej 204,773.75€, ku përfshihen kategoritë ekonomike: Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe Transfere, ndërsa shpenzimet për kategorinë ekonomike Paga dhe Shtesa të cilat menaxhohen dhe mbikëqyren nga MFPT-ja janë në shumë prej 845,636.78 €.

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2022 është në lartësi prej **2,759,758 Euro**.

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2022

KESH	Buxheti 2022	Realizimi TM2	%	Buxheti 2021	Realizimi TM2	%
Paga dhe shtesa	1,756,083.00	845,636.78	48.15%	1,650,453.41	810,386.79	49.10%
Mallra dhe shërbime	385,975.00	97,003.58	25.13%	353,165.39	157,735.16	44.66%
Shpenzime komunale	67,700.00	29,238.28	43.19%	67,000.00	25,274.42	37.72%
Subvencione dhe trans.	80,000.00	28,532.00	35.67%	80,290.00	33,885.00	42.20%
Shpenzime kapitale	455,000.00	49,999.89	10.99%	478,593.31	154,053.92	32.19%
Rezervat	15,000.00	-	0.00%	55,000.00	-	0.00%
TOTALI	2,759,758.00	1,050,410.53	38.06%	2,684,502.11	1,181,335.29	44.01%

2. SEKTORI PËR TË HYRAT

Në kuadër të këtij sektori janë kryer këto aktivitete:

- Përpunimi, harmonizimi dhe barazimi i evidencave të detajizuara të të gjitha llojet e të hyrave sipas programeve buxhetore, fondeve dhe kodeve ekonomike në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK).
- Përgatitja e raporteve për barazim me thesarin, si: barazimin mujor, tremujor me të hyrat vetanake.
- Përgatitja e raporteve për të hyrat vetanake për periudhën janar-qershor 2022 sipas drejtorive, sipas llojit të të hyrave dhe publikimi i raporteve në ueb-faqe të Komunës.
- Mbajtja e evidencave të sakta dhe shtimi i efikasitetit në arkëtimin dhe bankimin e pagesave – inkasimet në arkë, depozitimet bankare, transferi i të hyrave komunale dhe alokimin e këtyre mjeteve sipas planifikimit të drejtorive.

RAPORT I TË HYRAVE VETANAKE PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2022

Nr	Përshkrimi	Realizimi TM2 2022	Realizimi TM2 2021	Krahasimi në euro TM2 2022-2021
		2	3	5=2-3
1	Certifikatat e lindjes	105.00	45.00	60.00
2	Certifikatat e kurorëzimit	220.00	250.00	(30.00)
3	Certifikatat e vdekjes	24.00	26.00	(2.00)
4	Certifikata tjera ofiqarie	2,481.00	1,887.00	594.00
5	Taksa për verifikimin e dok. të ndryshme	20.00	21.00	(1.00)
6	Taksa administrative	100.00	-	100.00
I	Administrata e Përgjithshme	2,950.00	2,229.00	721.00
7	Tatimi në pronë dhe në tokë	99,049.09	86,175.60	12,873.49
8	Taksë për regjistrim të automjeteve	8,760.00	8,060.00	700.00
II	Buxhet dhe Financa	107,809.09	94,235.60	13,573.49
9	Të hyrat nga reklamimet publike	5,280.70	1,840.00	3,440.70
10	Licenca tjera për afarizëm	615.00	240.00	375.00
11	Taksa tjera administrative	216.00	180.00	36.00
12	Gjobat tjera	-	-	-
III	Shërbimet Publike	6,111.70	2,260.00	3,851.70
13	Të hyrat nga ushtrimi i veprimt. afariste	12,138.98	56,325.33	(44,186.35)
14	Gjoba nga Inspektoriati	500.00		

14	Licenca për pranim teknik të lokalit	-	20.00	(20.00)
IV	Zhvillimi Ekonomik	12,638.98	56,345.33	(43,706.35)
15	Taksa komunale për leje ndërtimi	902.58	7,534.89	(6,632.31)
16	Taksa komunale për demolim	-	-	-
17	Taksë për bartjen e pronësisë	2,398.00	2,940.00	(542.00)
18	Ndërrim destinimi i tokës	-	-	-
19	Shërbime të ndryshme kadastrale	3,444.00	4,918.50	(1,474.50)
20	Taksë për legalizim të objekteve	452.83	1,592.22	(1,139.39)
21	Shfrytëzimi i pronës publike	1,431.20	1,189.86	241.34
22	Të hyrat nga shitja e pasurisë	8,800.00	6,640.00	2,160.00
23	Gjobat nga inspektorati	550.00	-	-
	Të hyra nga konfiskimi	882.88		
24	Gjobat tjera	-	-	-
V	Urbanizimi dhe Kadastr	18,861.49	24,815.47	(5,953.98)
25	Participimet në arsim	7,055.00	6,080.00	975.00
VI	Arsimi	7,055.00	6,080.00	975.00
26	Taksa për shërbimet sociale	80.00	62.00	18.00
27	Certifikata mjekësore	810.00	870.00	(60.00)
28	Participimet në shëndetësi	1,475.60	3,054.70	-1,579.10
29	Inspektimi Higjieniko-Sanitar	-	10.00	(10.00)
VII	Shëndetësia dhe MS	2,365.60	3,996.70	-1,631.10
A	TË HYRAT DIREKTE	157,791.86	189,962.10	(32,170.24)
30	Të hyrat nga dënimet në trafik	3,720.00	2,550.00	1,170.00
31	Të hyrat nga dënimet në gjykata		-	0.00
B	TË HYRAT INDIREKTE	3,720.00	2,550.00	1,170.00
	TOTALI I PËRGJITHSHËM (A + B)	161,511.86	192,512.10	(31,000.24)

PLANIFIKIMI I TË HYRAVE

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2022 është në shumë prej 381,347.00 €.

Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtojë gjithsej 157,791.86 € për periudhën janar-qershor 2022 dhe paraqesin 41.3% e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2021 kemi një

rënie prej 34,720.24 € apo për 18%, (duke pasur parasysh që planifikimi i të hyrave për vitin 2022 është në shumë prej 381,347 €, ndërsa për vitin 2021 është 288,624 €).

Në bazë të drejtorive kemi këto të hyra:

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka mbledhur të hyra në shumë prej 107,809.09 €;
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka mbledhur të hyra në shumë prej 12,638.98 €;
- Drejtoria e Urbanizmit ka mbledhur të hyra në shumë prej 18,861.49 €;
- Drejtoria e Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport ka mbledhur të hyra në shumë prej 7,055.00 €;
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka mbledhur të hyra në shumë prej 2,365.60 €;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike ka mbledhur të hyra në shumë prej 6,111.70 €;
- Drejtoria e Administratës Komunale ka mbledhur të hyra në shumë prej 2,950.00€, si dhe të

hyrat nga

- Dënimet në trafik janë në shumë prej 3,720.00 € për periudhën janar-mars 2022, ndërsa për tre mujorin prill-qershor 2022 ende nuk na kanë ardhur të dhënat për shumën e të hyrave.

1. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë kësaj periudhe, kjo zyrë ka pasur këto aktivitete:

- Gjatë muajit shkurt kemi pranuar linkun për printimin e faturave të tatimit në pronë dhe tokë, ndërsa shpërndarja e tyre është bërë gjatë muajve mars-qershor 2022 për arsye të zgjatjes së afatit të ankesave dhe mungesa e stafit. Numri i faturave ka qenë 3477.
- Sipas dispozitave ligjore, pas pranimi të faturave të tatimit në pronë dhe në tokë, qytetarët kanë parashtruar 76 kërkesa për korrigjim ndaj certifikatës së pronës dhe 26 ankesa ndaj faturës së tatimit në pronë.
- Gjatë periudhës janar-qershor 2022 kemi arritur të bëjmë 18 marrëveshje për pagesën me këste të tatimit në pronë.
- Faturimi i tatimit në pronë dhe në tokë për vitin 2022 në Komunën e Hanit të Elezit është 225,572.00 €, ndërsa totali i inkasuar i tatimit në pronë dhe tokë për periudhën janar-qershor 2022 është 99,049.09 € apo 44% nga planifikimi duke përfshirë borxhet, kamatën dhe ndëshkimet nga vitet e kaluara.

Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTËR DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

I. PLANIFIKIMI

Në pajtim me kërkesat e Ligjit për planifikim hapësinor nr.04/L-174, Komuna është në fazën e hartimit, respektivisht përfundimit të hartimit dhe miratimit të Planit Zhvillimor të Komunës (PZHK) dhe Hartës Zonale të Komunës (HZK). Lidhur me këto dy dokumente strategjike të planifikimit hapësinor të Komunës, me kërkesë të Drejtorisë Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit, Kuvendi në muajin qershor ka marrë vendim për vazhdimin e afatit kohor për hartimin e këtyre dy planeve. Për PZHK-në, afati i ri për përfundimin e punës është dhjetori i vitit 2022, ndërkaj për HZK-në afati i fundit është muaji korrik viti 2022. Pavarësisht këtyre vonesave, puna rreth hartimit të këtyre dy planeve është në fazën finale. Tani me rradhë janë procedurat e organizimit të diskutimeve publike me qytetarë dhe grupe të interesit, marrja e pëlqimit (konfirmimit) nga Ministria e Planifikimit Hapësinor se PZHK dhe HZK janë në pajtim me Planin Hapësinor të Republikës së Kosovës si dhe miratimi nga Kuvendi i Komunës.

II. PROJEKTET INVESTIVE KAPITALE

Sektori i Urbanizmit në vazhdimësi ka qenë i angazhuar në të gjitha projektet investive kapitale përmes:

- Përgatitjes së paramasave dhe parallogarive për projektet kapitale të parapara për realizim në vitin 2021,
- Mbikëqyrjes së vazhdueshme të punimeve në terren dhe ndihma punëkryesve në realizimin e projekteve,
- Përgatitjen e aplikacion-projekteve për donator të ndryshëm,
- Përgatitjen e raporteve për projektet kapitale për Komunë, raporteve progresive të projekteve për Zyrën e Prokurimit, etj.

Më poshtë po japim listën e projekteve investive kapitale si dhe statusin e tyre momental:

Lista e projekteve kapitale për vitin 2022 në kuadër të DUKMM					
EMRI I PROJEKTIT	FINANCUESI I PROJEKTIT	BUXHETI	PUNË KRYESI	STATUSI MOMENTAL I PROJEKTIT	
Ndërtimi i Qendrës Kulturore në Han të Elezit	Komuna MKRS	270,000.00€	ATC COM.	Ka përfunduar Kostoja totale: 1,176,466 €	2019, 2020, 2021 dhe 2022
Rregullimi i parkut në rrugën “Isa Berisha”	Komuna MAPL	254,000.00€		Faza para fillimit të punimeve	2022
Asfaltimi i rrugës Gorancë-Krivenik	Komuna	5,000.00€		Është hartuar projekti detal	2022 2023
Gjelbërim i disa hapësirave publike	Komuna	23,000.00€		Para fillimit të punimeve	2022
Shtrim me kubëza betoni në zonat urbane dhe rurale Hani Elezit	Komuna MAPL	70,000.00€		E tenderuar	2022
Rregullimi i kanalizimeve nëpër zonat urbane dhe rurale të Hanit të Elezit	Komuna	20,000.00€		Projekti është në fazën paratenderuese	2022
Ndërtimi (rihapja dhe zgjerimi) i rrugëve në zonat rurale	Komuna	75,000.00€		Në fazën para tenderuese	2022

Rregullimi i shtigjeve për këmbësor dhe çiklistë përgjatë lumit Lepenc: Uji i TharëtKaçanik	Komuna	5,000.00€		Së bashku me komunën e Kaçanikut kemi aplikuar pranë UN-Habitatit dhe MAPL-s.	2022 2023
Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc	Komuna	5,000.00€		Banka Botërore ka miratuar realizimin e projektit. Në pritje të vendimit të Qeverisë	2022 2023 2024 2025
Inventarizimi i Qendrës Kulturore të Rinisë	Komuna	5,000.00€		Në fazën para tenderimit	2022
Fonde për shpronësim	Komuna	5,000.00€	MMPH	Është dorëzuar elaborati	2022, 2023
Ndërtimi i mureve mbrojtëse	Komuna	5,000.00€		Faza përgatitore	2022, 2023
Pyllëzimi i zonave të zhveshura në njësinë menaxhuese Uji i Bardhë	Komuna	3,000.00€			2022
Vendosja e pajisjes digjitale E-kioska	Komuna	10,000.00€			2022
Rregullimi i prockave dhe kanalizimeve atmosferike në zonat urbane dhe zonat rurale	Komuna	20,000.00€	Projekti është gati për konkurim pranë IPA fondeve	Në pritje të shpalljes së thirrjes për aplikim me Komunën e Tearcës	2022 2023

Shënim: Në listën e projekteve kapitale janë paraqitur vetëm projektet me kod 66480 Planifikimi Urban dhe Inspeksioni dhe jo projektet e tjera të cilat janë në listat e drejtorive tjera.

III. LEJET NDËRTIMORE

Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 3 aplikime për leje ndërtimore dhe janë dhënë 3 leje ndërtimore. Në raport me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar kemi një ulje të konsiderueshme të aplikimeve për leje ndërtimore (vitin e kaluar në gjashtëmujorin e parë janë dhënë 11 leje ndërtimore) me siguri si rezultat i krizës së përgjithëshme në vend.

Regjistri i lejeve ndërtimore të dhëna në gjashtëmujorin e parë:

1. Bajram Vila, Kategoria I, sip. 122.80 - taksa kom. 122.80€,
2. Sali Kuka, Kategoria I, sip. 180m² –taksa kom. 180€,
3. Elektra L.L.C, Kategoria II (objekt afarist) sip. 1,680.40m²-taksa komunale 1,680.40€,

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, nga taksa komunale për leje ndërtimore janë realizuar të hyra në shumë prej 1,983.20€ apo 180% më pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

IV. TRAJTIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE NDËRTIMORE (LEGALIZIMI)

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit, edhe vitin 2022 ka vazhduar me trajtimin e ndërtimeve pa leje ndërtimore sipas Ligjit të ri nr.06/L-024 për Trajtimin (legalizimin) e ndërtimeve pa leje të kategorisë së parë dhe kategorisë së dytë, i cili ka hyrë në fuqi me 5 Shtator 2018. Me këtë Ligj, janë reduktuar kërkesat për numrin e dokumenteve të cilat kërkojnë për legalizim, si dhe është mundësuar ulja e kostos (shpenzimeve) për aplikim. Ligji, gjithashtu parasheh hartimin dhe aprovimin e programeve të veçanta për trajtimin e ndërtimeve pa leje në prona publike, prona shoqërore, toka bujqësore nën komasacion dhe nën sistem të ujitjes, korridore infrastrukturore, sipërfaqe të mbrojtura, zona të veçanta të mbrojtura, etj.

Përndryshe, në Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit në fillim të vitit apo gjashtëmujorin e parë kanë aplikuar vetëm katër qytetarë për legalizim të objekteve ndërtimore pa leje dhe që të gjithë janë pajisur me certifikatë të legalizimit. Nga këta 4 aplikues, 2 prej tyre janë liruar nga pagesa e taksës komunale për legalizim, meqenëse të njëjtat janë ndërtime para vitit 2004. Të hyrat e realizuara në emër të taksës për legalizim për periudhën e lartëpërmendur janë në shumë prej 452.83 € apo 167.9% më pak se gjashtëmujorin e parë të vitit paraprak. Vlerësojmë se numri i të interesuarve për legalizim të ndërtimeve pa leje ndërtimore ende mbetet tepër i ulët dhe kjo është më shumë si pasojë e krizës së përgjithëshme, si dhe çmimet e larta të shërbimeve kadastrale të operatorëve të licencuar për ofrim të këtyre shërbimeve.

Ndërkaq, sa i përket uzurpimeve të pronës komunale, në periudhën raportuese nuk është vërejtur apo raportuar ndonjë rast i uzurpimit.

V. SHFRYTËZIMI I TOKËS NDËRTIMORE DHE OBJEKTIT BANESOR (NDËRTESA E TË VETMUARVE) PRONË E KUVENDIT KOMUNAL

Sa i përket shfrytëzimit të tokës pronë e Kuvendit të Komunës si dhe shfrytëzimit me qira të objektit banesor (ndërtesa e të vetmuarve) po ashtu pronë komunale, nuk ka asnjë ndryshim në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Edhe më tutje, janë 23 shfrytëzues me kontratë të tokës pronë e Kuvendit Komunal (ku janë të vendosura kryesisht lokalet me karakter të përkohshëm, garazhe e të tjera, si dhe 6 shfrytëzues të objektit banesor (banesa e të vetmuarve-pesë prej tyre për qëllime të banimit dhe njëri për lokal). Sipërfaqja e përgjithshme e tokës të dhënë me qira është 424.8m². Ndërkaq sipërfaqja e banesave të dhëna me qira është 392.5m². Faturimi vjetor për shfrytëzuesit e pronës komunale (tokës dhe banesave) është 6,042€. Përndryshe në periudhën Janar-Qershor 2021, Drejtoria ka inkasuar në emër të taksës për shfrytëzim të pronës komunale shumë prej 1,147 € që është për 3.6% më pak se periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

VI. MBROJTJA E MJEDISIT

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë bërë inspektime të rregullta nga inspektorja e mjedisit dhe aty ku është parë e arsyeshme janë bërë vërejtje me gojë dhe shkrim (procesverbale). Po ashtu, është shqiptuar edhe një gjobë mandatore në shumë prej 100.00 € në emër të ndotjes së mjedisit. Në vazhdimësi është monitoruar ndotja nga “SharrCem” ku me shkresë zyrtare i jemi drejtuar Sharrcemit, me ç’rast kemi shprehë paknaqësitë tona dhe të qytetarëve lidhur me ndotjen e ajrit ku kemi kërkuar që të marrin masa për parandalimin e ndotjes së ajrit, si dhe kemi njoftuar inspektorët e MMPH-së dhe kemi inspektuar së bashku.

Sektori i Mjedisit ka bërë identifikimin e deponive ilegale dhe në bashkëpunim me kompaninë “Pastrimi” është bërë pastrimi dhe eliminimi i tyre.

Po ashtu, me një aksion për pastrim të organizuar nga Komuna kemi shënuar Ditën Ndërkombëtare të Tokës.

Në periudhën raportuese, Sektori i Mjedisit ka lëshuar një Leje Mjedisore Komunale e cila ndërlidhet me një ndërtim të kategorisë dy.

Të hyrat e sektorit të Mjedisit gjashtëmujorin e parë të vitit 2022

Emërtimi	Gjashtëmujori parë 2021	Gjashtëmujori parë 2022
Të hyrat nga gjobat mandatore	1,968 €	589.78 €
Të hyrat nga pëlqimet mjedisore	0.00 €	100 €
Gjithsej:	1,968 €	689.78 €

VII. KADASTRI

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, Kadastri ka shënuar zvogëlim të numrit të kërkesave, respektivisht lëndëve nga 848 sa ishin në gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar në 815 sivjet ose 33 lëndë më pak. Më poshtë po japim tabelën e lëndëve të realizuara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022:

Raporti i lëndëve të kryera në gjashtëmujorin e parë viti 2022

Emërtimi i kërkesës	Numri i kërkesave	Pagesa
Çertifikata prone	319	1,008 €
Kopje plani	205	820 €
Bartje pronësie	52	1,710 €
Ndarje fizike të parceleve	47	800 €
Blerje të pikave	108	970,€
Bashkim të parceleve	3	70 €
Vërtetim që nuk posedon pronë	27	54 €
Modifikim pronësie	0	0.00€
Regjistrim hipoteke	2	500 €
Ç’regjistrim hipoteke	1	0.00 €
Historiat të parceleve	0	0.00 €

Regjistrim objekti (njësi banesore)	2	0.00 €
Korigjim të sipërfaqeve	9	0.00 €
Përgjigje në kërkesa për info. kadastrale	5	0.00 €
Kërkesë për heqjen e masës së përkohshme	0	0,00€
Kontrata për shfrytëzim të pronës Komunale	1	0.00€
Kërkesë për modifikim të attributeve të parceleve	4	60 €
Të tjera të ndryshme	22	40€
Taksa për shfrytëzim të pronës publike	8	1,147, €
GJITHSEJ:	815	7,179 €

Në periudhën Janar-Qershor Kadastri ka realizuar të hyra në shumë prej 7,179€ apo për 24.55% më pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

TË HYRAT E DREJTORISË PËR GJASHTËMUJORIN E PARË 2022

Të hyrat e Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit, në gjashtëmuorin e parë të vitit 2022 janë në shumë prej 10,303€ apo 71.6% më të ulëta se periudha e njëjtë e vitit të kaluar.

Të hyrat e drejtorisë për periudhën Janar-Qershor 2021 dhe 2022

SEKTORI	Të hyrat 2021 viti	Të hyrat 2022 viti
Urbanizmi	6,767 €	2,435 €
Kadastrë	8,944 €	7,179 €
Mjedisit	1,968 €	689 €
Gjithsej të D U K M M	17,679 €	10,303 €

Drejtori i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit

Nexhmedin Daci

DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Drejtoria për Arsim, Kulturë Rini e Sport (DKAKRS), gjatë periudhës Janar-Qershor 2022 ka kryer punët dhe detyrat të cilat kanë ndihmuar në përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe ngritjen e cilësisë në mësim përmes pajisjes së shkollave me material të nevojshëm, si dhe organizimin e trajnimeve për mësimdhënës. Arritja e marrëveshjes së bashkëpunimit për digjitalizimin e shkollave në Komunën tonë me platformën eShkollori, si mundësi tejet e rëndësishme për ngritjen e cilësisë në arsim duke përdorur metodat e teknologjisë bashkëkohore. Janë mbajtur takimet në MASHT, me Inspektorët e punës, me KFOR-in, Policinë e Kosovës OSBE-në, KRCT, si dhe takime të rregullta me bordin e drejtorëve, drejtorët e shkollave dhe Këshillin Komunal për Siguri dhe Bashkësi në Komunën e Hanit të Elezit. Së bashku me to, Drejtoria ka përfaqësuar Komunën në të gjitha fushat që i përkasin Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit në të gjitha eventet, konferencat dhe punëtoritë.

Nr.	Koha	Aktivitete e punës	Komentet
1	Janar 2022	- Kemi arritur marrëveshje mirëkuptimi me OJQ-në “TOKA”. - U zhvillua Turneu Ndërkombëtar i Mundjes. - Është zhvilluar një aktivitet me fëmijët e riatdhesuar në SHFMU “Veli Ballazhi”	KRCT - Kosova Rehabilitation Centre for Torture Victims
2	Shkurt 2022	- Festën e “17 Shkurtit” të organizaur nga SHFMU “Ilaz Thaçi” dhe nga Komuna. - Shënohet “21 Shkurti”, ku kemi organizuar një akademi përkujtimore për Gafurr dhe Driton Lokun. “26 Shkurtit”, evokim rreth ngjarjes së kësaj date me shkollat e mesma të ulëta, si dhe me Këshillin e Nxënësve nga Sh.M.L. “Dardania” ishim në Puset e Nikës ku përkujtuam dhe diskutuam rreth kësaj dite në formë bashkëbisedimi interaktiv. Së bashku me pedagogët e sportit, e kemi rregulluar orarin për të zhvilluar aktivitete jashtë shkollore;	

3	Mars 2022	▪ Është realizuar Olimpiada e Matematikanëve të Rinjë; ▪ Kemi zhvilluar puntorinë me përfaqësues të Ambasadës Angleze, Drejtorin për Siguri Publike dhe Drejtorin e KundërTerrorizmit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm; ▪ Më 5 mars manifestuam “Epopenë e UÇK-së” me mbledhje Solemne të Kuvendit; ▪ Me 7 Mars, nominimi i mësimdhënësit më të mirë në nivel komunal; ▪ Kem pasur monitorim parandalues dhe vetëdijsues për sjelljen dhe bartjen e mjeteve të ndaluara në shkollë së bashku me ▪ Këshillin e Prindërve në SH.M.L. “Dardania”; ▪ Me misionin e Kombeve të Bashkuara, është planifikuar dhe zbatuar projekti për vendosjen e filterave të ujit të pijshëm në shkollën fillore. ▪ Takimin informues tek Shtëpia e Sportit, për projekte për investime kapitale; ▪ Bashkëpunim me organizatën YARL, nga ku ishim në terrenet e Puset e Nikës për projektin me Ministrinë e Kulturës për “Evidentimin e dëmeve në zonat kulturore në Letnicë dhe Puset e Nikës”;	(Fadil Curri) SHFMU “Ilaz Thaçi” Pustenik
---	--------------	---	--

4	Prill 2022	▪ Rithemelimi i klubit të karates KK “SHARRI”; ▪ Dita e shkollë “Ilaz Thaçi”; ▪ Është shënuar 23 vjetori i përkujtesës së dëbimit të shqiptarëve “Bllaca 99”; ▪ Puntori me OSBE-në me temën "Angazhimi i burrave në promovimin e barazisë gjinore në nivelin lokal”; ▪ Kemi shënuar Ditën e të Pagjeturve, ▪ Shënimit të ditës së "Vajzave në TIK”; ▪ Projekti "Shpresa" është realizuar, është kompletuar klasa me lodra didaktike, inventarizim, e gjitha që ishte në marrëveshje që kanë kërkuat të përditësojmë marrëveshjen.	Manifestim kushtuar ditës së shkollës “Bllaca 99”; 23 Prill Caritas Zvicerian me marrëveshjen e përditësuar.
5	Maj 2022	▪ Ministria e Arsimit, për digjitalizimin e sistemit të Arsimit, ku do të punësohen asistente/ë për drejtimin TIK-ut, poashtu do të punësohen asistente/ë në sistemin për fëmijë me nevoja të veçanta dhe për këshilltarë të karrierës për shkollat e nivelit të mesëm të ulët; ▪ Më 21 maj nxënësit e shkollave fillore të mesme të ulëta ishin në gara të IQ, një lloj sfide që u realizua në Mehmet Akif për klasat 8 dhe 9, ku dy nxënëse nga SHFMU “Ilaz Thaçi” ishin fitues të vendit të dytë dhe tretë në nivelin regjional. ▪ Kemi filluar ekzekutimin e shujtave dhe lëngjet për nxënësit e klasave 1-5,	Takim pune me Ministrinë e Arsimit Gara të IQ (intelegjencës) Bashkëfinacim me MASHT

5	Maj 2022	▪ USAID dhe KEDS si bashkëfinancues që kanë investuar në pajisjet teknologjike për mësimin jashtëkurrikular, tek SHML “Dardania”, projekti ASSET. ▪ Arkivi shtetëror, takim informues nga ku materialet e Arkivit shkollor do të dërgohen në Qendrën Rajonale të Arkivit në Ferizaj; ▪ Marrëveshje Mirëkuptimi mes Këshillit të Fshatit Seçishtë dhe Drejtorisë Komunale për kompletimin e një kabineti të informatikës në shkollën fillore “Veli Ballazhi” në Gorancë, të cilat kanë qenë të dhuruara nga Caritas-i Zvicerian (10 kompjuterë); ▪ Kemi nënshkruar Marrëveshjen e Mirëkuptimit për projektin “YENI” me Caritas-in Zvicerian; ▪ Dëgjimin publik për plotësim-ndryshimin e rregullores për ndarjen e bursave ▪ Qendra Rajonale të Trashëgimisë Kulturore të Ferizajit;	Puntori në Prishtinë me projektin ASSET Takim me zyrtarët e Arkivit shtetëror Projekt me të rinjtë e qytetit 31.05.2022 Takim pune me zyrtar për trashëgiminë K.
6	Qershor	▪ Zhvilluam aktivitetet e javës kulturore; ▪ U zhvilluan lojëra për Komitetin Olimpik të Kosovës; ▪ Marrëveshje Bashkëpunimi me Illyrian shpk, për shërbimin (free) për 1 vjet, ofrimin e digjitalizimit të eShkollorit, ku faza e parë e trajnimit ka filluar. ▪ Kemi aplikuar në 3 projekte të ofruara (pajisja e shkollave me nga një tabelë digjitale “smart board” 86" inc, Inventarizimi dhe furnizimi me shtretër për fëmijet, tek çerdhja dhe një ekran digjital për Qendrën Kulturore)	Nga 111qershor. e-Shkollori Faza fillestare Shkollat Çerdhja Qendra Kulturore

Raporti 6 muhor për bibliotekën e qytetit në Han të Elezit 2022

Sa i përket Bibliotekës Komunale të qytetit jemi në fazën e transferimit nga SHFMU “Ilaz Thaçi” pranë qendrës Kulturore “Imri Curri”.

Fondi i librave në bibliotekën amë në Komunën Hani i Elezit

Në gjuhët	Shqipe	Serbe	Turke	Të tjetra	Gjithësej
Në numër	5640	14	22	334	6010

Rapoti vjetor për Kulturë, Rini dhe Sport Janar – Qershor 2022

Nr.	Koha	Aktivite për Kulturë
-----	------	----------------------

17.02.2022	Hani i Elezit shënon 14 vjetorin e Pavarësisë së Republikës të Kosovës Komuna e Hanit Elezit, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me aktivitete kulturore shënoi ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Ku aktivitetet filluan me homazhe në Varrezet e Dëshmorëve në Pustënik për të nderuar sakrificën e Dëshmorëve të trevës së Hanit të Elezit. Manifestimi i Ditës së Pavarësisë u mbyll me një program kulturor nga SHKA"Sharri"
21.02.2022	Me Akademi mirënjohje përkujtohen Dëshmorët Gafur e Driton Loku. Kjo ngjarje përkujtimore u mbyll me program artistik të përgatitur nga nxënësit e SHFMU "Ilaz Thaçi" dhe SHKA "Sharri".
26.02.2022	"26 Shkurti" shënon ditën e qëndresës, rezistimit dhe krenarisë, ditën e krismës së pushkës së parë nga UÇK-ja në Puset e Nikës.
10.04.2022	U shënua 23 vjetori i ngjarjeve të dhimbshme në Historinë e Kosovës Eksodi "Bllaca 99". SHKA "Sharri" shfaqti një program kulturor, si dhe poezi nga poetët.
22.04.2022	Hani i Elezit shënon Ditën e Tokës me moton "Ta mbrojmë Kosovën".
27.02.2022	SHML"Dardania" nga Hani i Elezit rrëmben dy çmime në garat regjionale në Futsall
10.05.2022	Mbahen garat Komunale në voleyboll për nxënësit e shkollave fillore nën mbështetjen e drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
01.02.2022	Me rastin e shënimit të 11 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Komunës së Hanit të Elezit, Komuna e Hanit të Elezit, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport duke filluar nga 1 qershori deri me 11 qershor me aktivitete kulturore dhe sportive.
01.06.2022	Dita e fëmijëve

01.06.2022	Zhvillohet performanca Teatore “ME KËNGËT E RIZAH BLLACËS” në Ambientin e Restaurantit “Albani” në Puset e Nikës, nga ora 20:00h
02-10.06.2022	U zhvillua turnir në futboll të vogël duke filluar nga 2 qershori deri më 10 qershor ku u mbajt finalja, vend i parë i takoi DJ Niki dhe vend i dytë i takoi FSK-së
04.06.2022	U zhvillua Turneu i Paqës në mundje , organizuar nga Klubi i Mundjes “Dardania” nga Hani i Elezit
10.06.2022	Për nder të Ditës së Çlirimit Shoqata e Shkrimtarëve “ABC-poetike” nga Shkupi, të cilët organizuan manifestimin tradicional “Ora Poetike” në Komunën e Hanit të Elezit
11.06.2022	Nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport u organizua gara në “Vrapimi tradicional –Hani i Elezit 2022” me nxënësit e shkollave fillore të Komunës së Hanit të Elezit.
11.06.2022	Më 11 qershor mbahet përvjetori i 23-të i Ditës së Çlirimit të Hanit të Elezit me një program kulturo-artistik me këngë dhe valle, me këngëtarë veteran të Shoqërisë Kulturo-Artistike “Sharri”si dhe këngëtarë mysafirë.
18.06.2022	U shfaq premiera e filmit dokumentar “Gjaku i nxënësit Isa (Muhamet) Brishashenjë e kujtesës historike”. Premiera u shfaq në Shtëpinë e Kulturës “Imri Curri” , ku pati edhe një këngë kushtuar nxënësit Isa Berisha nga këngëtari Shaban Rogaqi. Producente: ErzaRamuka Regjisor : Nusret Pllana Skenari : Emin Kabashi Montazha Gramos Salihu Sponzor gjeneral “AlbaGoup”, Hani i Elezit

Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
Hisni Luri

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Duke u bazuar në Ligjin e Shëndetësisë së Kosovës si dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale i cili ka inkorporuar në tërësi konceptin e Mjekësisë Familjare duke e definuar atë si “formë themelore e ofrimit të shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse në nivelin parësor të kujdesit shëndetësor, për individët dhe familjet e tyre”, KPSH në Komunën e Hanit të Elezit shërbimet shëndetësore i ofron në bazë të konceptit të Mjekësisë Familjare bazuar në legjislacionin në fuqi.

Aktivitetet në nivel të DSHMS-së:

- Më 01.03.2022 është bërë rifunksionalizimi i AMF-së në fshatin Gorancë,
- Projekti i ri i punimit të tavanit në QKMF- projekti i cili i është bashkangjitur projektit të Ngrohjes,
- Procesi i asgjësimit të barnave me afat të skaduar që nga viti 2012 është në përfundim, pasi regjistrimi i të gjitha barnave është bërë sipas Udhëzimeve Administrative,
- Më 30.05.2022 janë realizuar të gjitha pagat Jubilare për punonjësit shëndetësorë të paraparë nga Kontrata Kolektive me mbi 20 dhe 30 vite përvojë pune, □ Rregullimi i aparaturës së RTG-it.

Informatë mbi gjendjen në shëndetësi për periudhën Janar - Qershor 2022

Ngritja e cilësive së shërbimeve shëndetësore dhe realizimi i standardeve të cilësisë nga pakoja e standarteve minimale në KPSH:

- Furnizimi i rregullt me barna dhe material mjekësor nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë,
- Raportimi i rregullt në IKSHP-në rajonale për sëmundjet ngjitëse dhe tumoreve (kancerit) dhe sëmundjeve kronike në IKSHP në Prishtinë,
- Transportimi i rregullt i pacientëve në Hemodializë në Ferizaj (e hënë, e mërkurë dhe e premte). (Ky orar mund të ndryshojë sipas numrit të pacientëve),
- Mbajtja e rregullt e edukimit të vazhdueshëm profesional për infermier, trajnimi i personelit në mjekësinë familjare dhe ligjërata të rregullta në procesin e ZHVP-së, □ Përcellja e punës dhe funksionimit normal në ambulantën e fshatit Guranë.
- Sigurimi i shërbimeve shëndetësore 24 orëshe në QKMF - Hani Elezit.
- Mbajtja e rregullt e takimeve të Keshillit Drejtues dhe atij Profesional.
- Mbajtja dhe ruajtja e pastërtisë dhe ambientit të këndshëm për punë.
- Mirembajtja dhe ruajtja e automjeteve të QKMF-së dhe sigurimi i karburantit për automjete dhe gjenerator.
- Ruajtja e sekretit profesional dhe konfidence në raportet e pacientëve.
- Ruajtja dhe sigurimi i dokumentacionit mjekësor nga personat e paaautorizuar.
- Bashkëpunimi me DSHMS-në dhe subjektet tjera komunale.
- Bashkëpunimi me Qendrat tjera të mjekësisë familjare të komunave të Kosovës.
- Bashkëpunimi me KFOR-in dhe organizatat e tjera të huaja.
- Bashkëpunimi me organizatat vendore joqeveritare dhe qeveritare.
- Planifikimi i vaksinimit dhe imunizimit të mbi 95% të fëmijëve dhe vaksinimi i plotë me vaksinën ANTI COVID sipas programit të imunizimit.

- Zvogëlimi i morbiditetit dhe mortalitetit të nënave shtatëzane dhe fëmijëve të posalindur.
- Zvogëlimi i komplikimeve të sëmundjeve kronike dhe menaxhimi adekuat i tyre.
- Parandalimi i sëmundjeve ngjyeshme dhe sëmundjeve të tjera.
- Parandalimi i sëmundjeve kancerogjene sipas planit strategjik për mbrojtje nga këto sëmundje.
- Planifikojmë rritjen e numrit të vizitave shtëpiake të nënave dhe fëmijëve 0-3 vjet.
- Planifikojmë rritjen e vizitave dhe këshillave të programit Aksioni për Nënë dhe Fëmijë.
- Planifikimi i kontrolleve sistematike tek nxënësit e shkollave fillore në Komunën e Hani të Elezit në muajin shtator 2022.

Gjatë periudhës Janar- Qershor në QKMF ka pasur këto aktivitete :

- Kërkesa të vazhdueshme në MSH-së për rritje të stafit në sektorin e Shëndetësisë.
- Kërkesë për asgjësimin e barnave me afat të skaduar.
- Shënimin e ditëve botërore në Shëndetësi dhe aktivitete edukativo-shëndetësore.

Donacionet gjatë kësaj periudhe gjashtëmuajore

1. Donacion nga KFORI Italian 23/12/2021

Nr.	Emri gjenerik	Sasia	Njësia
1	Matës manual të presionit	40	copë
2	Otoskopa	5	copë
3	Matës të pulsit për gishtërinj	2	copë
	Koncentruer të oksigjenit	1	copë
6	Komplete të tubave për intubim prej 7.5 mm	20	copë
7	Komplete të tubave për intubim prej 8.5 mm	20	copë
	për defribilim	4	copë
8	Pako të elektrodave		
9	Manometra të oksigjenit	10	copë
10	Sterilizatore manuale për tharje	1	copë
11	Shtrat për rianemim	1	copë
12	Kontenitorë të mëdhenj për sterilizim	5	copë
13	Kontenitorë të mesëm për sterilizim	5	copë
14	Kutia për pajisje kirurgjike	10	copë
15	Dana të holla	20	copë
16	Dana kirurgjike	20	copë
17	Gërshërë kirurgjike	20	copë
18	Karriga për invalidë	5	copë
19	Pateriza	10	palë

20	Tavolinë me pajisje medicinale me kaseta	1	copë
21	Çanta për ndihmë të shpejtë (për paramedik)	1	copë
22	Termometra për Frigoriferë	5	copë
23	Frigoriferë për ftofjhen e vaksinave	2	copë
24	Matës të sheqerit (Glikemie)	10	copë
25	Kutia të shiritave për matjen e glikemisë	20	copë
26	Analizator për Urine	1	copë
27	Epruveta për laboratorë	10	copë
28	Matës Digjital (kronograf)	1	copë

2. Donacion nga SHARRCEM 25/03/2022

Nr.	Emri gjenerik	Sasia	Njësia
1	Shiringa 60 ml	3x100	Pako
2	Pambuk	3	Copë

Donacion nga IOM KOSOVA 29.03.2022

Nr.	Emri	Sasia	Njësia
1	Printer – scanner	1	copë
2	Projektor	1	copë
3	Tabelë manuale projektuese	1	copë
4	Ulëse	5	copë
5	Banera edukativo-shëndetësor	2	copë

Donacion nga HENDIKOS 16/05/2022

Nr.	Emri	Sasia	Njësia
1	Karroca	2	copë
2	Shëtitore	1	copë
3	Kolostoma dhe pampersa	50	copë

Donacion nga Action Mother of Children 06/07/2022

Nr.	Emri	Sasia	Njësia
3.			

4.

5.

1	Peshore	1	copë
2	Aparat të glikemisë	2	copë
3	Shirita te glikemise	2	pako

6. Donacion nga UNICEF KOSOVA 30/03/2022

Nr.	Emri	Sasia	Njësia
1	Karriga të plastikës	30	copë
2	Frigorifer për vaksina	2	
3	Tavolinë pune	2	pako
4	Otoman	1	copë
5	Paravan	1	copë
6	Termometër digjital	2	copë
7	Safety box	500	copë
8	Hansaplast	200	copë
9	Dezinfektues gel	400	copë
10	Sapun i lëngshëm për duar	70	copë
11	Domestos	50	copë
12	Sprej për dritare	20	copë
13	Paloma të lagura antibakterial	60	copë
14	Trollex	30	copë
15	Palloma kuzhine	60	copë
16	Xhoker	10	copë
17	Faks-detergjent	10	copë

QKMF-ja gjatë kësaj periudhë ka punuar me një staf prej 32 punëtorëve

Nr.	Shërbimi /Sektori	Vendi i punës	Staf
2	QKMF	Drejtor	1
		Mjek	6
		Kryeinfermiere	1
		Infermier	18
		Laborant	1

		Teknik i radiologjisë	1
		Farmaciste	1
		Puntorë teknik	3

Në mbështetje me resurse humane, Ministria e Shëndetësisë ka angazhuar 2 mjekë të përgjithshëm dhe 5 infermiere, të cilat janë angazhuar në procesin e menaxhimit të vaksinimit AntiCovid dhe mbështetjen e procesit të punës në shërbimet e përgjithshme shëndetësore në QKMF-Hani Elezit.

▪ **Punëtorët e QKMF-së të cilët kanë qenë të kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë deri me 15.06.2022**

Nr.	EMRI	MBIEMRI	POZITA
1	Qenan	Maliqi	Mjek i përgjithshëm
2	Ardit	Gola	Mjek i përgjithshëm
3	Mirlinda	Krasniqi	Infermiere
4	Ilire	Azemaj	Infermiere
5	Doruntina	Dernjani	Infermiere
6	Zelije	Livoreka	infermiere
7	Bukurije	Aliu	Infermiere

Spektori i Mjekësisë Familjare (Orari 7^h -15^h)

Në Sektorin e Mjekësisë Familjare ofrohen këto shërbime shëndetësore:

- Shërbimet laboratorike dhe RTG
- Imunizimi – Vaksinimi – Shërbimet e triazhimit
- Shërbimet mjekësore administrative – SISH (Sistemi i Informimit Shëndetësor) tani online.
- Vizitat shtëpiake për të sëmuarit palativ (të palëvizshëm).

Spektori i shëndetit publik

Analiza e të dhënave, sistematizimi dhe raportimi i rregullt kanë qenë objektivat e realizimit në Njësinë e Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH) .

Spektori i Vaksinimit ka kryer vaksinimin e rregullt të të gjitha grupmoshave, të dy gjinive sipas kalendarit të vaksinimit. Vaksinimin e rregullt të fëmijëve deri në moshën 19 vjeçare (sipas kalendarit të vaksinimit) dhe rastet e lëndimit me vaksinën Antitetanike mbi moshën 19 vjeçare.

Spektori i Diagnostikës

Gjatë kësaj periudhe për analiza Laboratorike dhe Rentgenologjike janë siguruar material i domosdoshëm për punë, kështu që janë ofruar shërbime si kuantitative (sasiore), po ashtu edhe kualitative (cilësore). Sigurimi i reagensëve për analiza laboratorike që janë mungesë në listën e barnave esenciale dhe sigurimi i disa medikamenteve dhe materialit shpenzues për mbulimin e shërbimeve shëndetësore janë siguruar nga buxheti komunal. Aparati i rentgenit tash e tutje është në funksion të plotë.

Sektori i Emergjencës

- Ky sektor ka ofruar shërbime 24/7, i cili ka qenë një nga prioritetet në organizimin, menaxhimin dhe furnizimin me medikamente dhe material shpenzues, si: shiringa, gjilpëra, material për fashim. Për menaxhim të rasteve në këtë sektor, shërbimet janë ofruar edhe jashtë QKMF-së dhe rastet emergjente që iu referohen nivelit sekondar dhe terciar, sipas thirrjeve nga ana e pacientëve, po ashtu edhe zyrtarëve policor dhe institucioneve në menaxhimin e emergjencave.
- Vizitat shtëpiake tek pacientët me COVID-19. Përveç linjës 194 dhe një linjë tjetër telefonike pa pagesë për kërkim të ndihmës mjekësore dhe informacione falas me numrin (0800 15 550).

Muajt	Emergjenca		Vizitat shtëpiake	
Viti	2021	2022	2021	2022
Janar	928	1396	97	71
Shkurt	1002	1021	79	80
Mars	1769	1030	64	75
Prill	1625	1327	55	53
Maj	1999	1390	59	79
Qershor	1531	998	62	78
Totali	8854	7162	416	436

Shërbimet në Ambulancën e Mjekësisë Familjare në Gorancë

AMF Gorancë ofron shërbime shëndetësore dy herë gjatë javës (të martën dhe të enjten nga ora 08:00-12:00). Ekipa e cila punon gjatë terrenit në AMF është i përbërë nga mjeku dhe infermieri i QKMF-së.

Muajt	Kontrollet mjekësore		Intervenime		Vizitat Shtëpiake		Vizitat për Nënë dhe Fëmijë	
Viti	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Janar	00	00	27	00	13	00	00	00

Shkurt	00	00	12	00	18	00	00	00
Mars	00	29	38	33	9	00	00	00
Prill	00	31	42	8	11	1	3	00
Maj	10	28	38	12	12	2	00	00
Qershor	00	40	8	15	27	00	00	00
Totali	00	132	77	68	40	00	00	00

▪ **Rastet e sëmundjeve malinje në Komunën tonë**

Lloji i sëmundjes	Nr i rasteve		Gjinia	
VITI	2021	2022	2021	2022
CA PULMO	0	0	F-1 M-0	F-0 M-0
CA ENDOMETRIUM	1	0	F-1 M-0	F-1 M-0
CA PROSTATES	0	1	F-0 M-0	F-0 M-0
CA MAMAE	3	1	F-3 M-0	F-1 M-0
CA Faringitis	1	1	F-0 M-1	F-0 M-1
Ca Pancreatis	1	2	F-1 M-0	F-1 M-1
Ca Rectum	1		F-0 M-0	F-0 M-0
Tu Cerebri	1	1	F-1 M-1	F-1 M-0
Totali	8	6	6 2	F-4 M-2

PLANPROGRAMI PËR ZHVILLIMIN E VAZHDUESHËM PROFESIONAL INFERMIEROR 2022

Nr	Tema	Ligjëruesi		Data e mbajtjes
1	Kujdesi infermieror tek pacientët me pasojat e post-covid-19.	21.01.2022	10-15 infermierë	1 ligjëratë (15-20)
2	Kujdesi infermieror tek rastet emergjente.	18.02.2022	10-15 infermierë	1 ligjëratë (15-20)
3	Administrimi i terapisë paraenterale (Im,Iv,Sc,Id).	11.03.2022	10-15 infermierë	1 ligjëratë (15-20)

4	Dita Botërore e Shëndetit (Rëndësia e të ushyerit të shëndetshëm).	07.04.2022	10-15 infermierë	1 ligjëratë (15-20)
5	Planifikimi familjar (Kujdesi infer. për HTA dhe Diabet)	20.05.2022	10-15 infermierë	1 ligjëratë (15-20)
6	Drogat dhe pasojat e përdorimit të tyre.	10.06.2022	10-15 infermiere	1 ligjëratë (15-20)

Shënimi i ditëve ndërkombëtare në shëndetësi

Ditët Ndërkombëtare në Shëndetësi shënohen sipas programit zyrtar të përpiluar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Këto aktivitete zbatohen në përputhje me natyrën e sëmundjes, e cila prek më shumë komunitetin dhe shoqërinë tonë.

Sipas Ditëve Ndërkombëtare në Shëndetësi, qendra jonë ka zhvilluar disa aktivitete në shkolla dhe në komunitet, si qëllim kryesor senzibilizimin e popullatës për një shëndet dhe mirëqenie të plotë shëndetësore (matje e glikemisë, tensionit, peshës trupore dhe shpërndarja e broshurave).

- **7 Prill - Dita Botërore e Shëndetit (është mbajtur në shkolla)**
- **12 Maj - Dita Ndërkombëtare e Infermierisë (në komunitet)**
- **19 Maj - Dita Ndërkombëtare e Mjekut Familjar (në komunitet)**
- **31 Maj - Dita Botërore kundër Duhanit (në shkolla)**

Pandemia COVID-19

Për shkak të rrethanave nga Pandemia COVID-19 edhe gjatë këtij viti janë zhvilluar aktivitete të ndryshme:

- Bashkëpunimi me institucionet qendrore me qëllim të menaxhimit dhe informimit për gjendjen me koronavirus në komunën tonë.
- Raportohet çdo ditë në IKSH, IRSHP, DSHMS dhe qendrën e menaxhimit të rasteve pozitive.
- Janë evidentuar rastet pozitive dhe rastet e dyshimta të qytetarëve të komunës tonë
- Të gjithë qytetarët të cilët janë identifikuar si të dyshuar se janë të infektuar me koronavirus janë testuar në QKMF “Dr Menduh Kaloshi” me teste **Serologjike** apo **Rapide**, dhe varësisht nga rezultati, qytetarët janë këshilluar nga personeli mjekësor për veprimet e mëtejshme.
- Në kuadër të QKMF-së është duke vazhduar procesi i vaksinimit kundër koronavirusit sipas vendimeve dhe rekomandimeve të institucioneve qendrore, gjegjësisht Ministrisë së Shëndetësisë **Të hyrat vetanake në QKMF gjatë periudhës Janar – Qershor**

Të hyrat vetanake	2021	2022
QKMF	7,721.50 €	2,109.50 €

Barnatorja Qendrore

Insulinat (pacientët për periudhën Janar - Qershor 2022 janë gjithsej 79)

Nr.	Emri komercial	Numri i insulinav
1	Novorapid	60,600
2	Levemir	54,300
3	Novomix	372,900

Qendra për Punë Sociale

Duke e pasur parasysh gjendjen e pandemisë dhe ngritjen e çmimeve të produkteve, por edhe muajin e shenjtë të Ramazanit kemi pasur përkrahje nga organizata të ndryshme për t'i ndihmuar familjet në nevojë me pako ushqimore e higjienike, si:

- **120 pako**-me nismë të Jusuf Ismailit përmes donatorëve:“I love to help”, “Infaq e V” dhe “Ilion Group”
- **200 pako**-në bashkëpunim me Këshillin e Bashkësisë Islame në Han të Elezit të dhuruara nga “T.C. Vakıflar Genel Mudulugu”.
- **109 pako**-“Islamic Relief Kosova”.
- **40 pako**-Ambasada e Emirateve të Bashkuara me seli në Mal të Zi në bashkëpunim me Departamentin e Mirëqenies Sociale.
- **150 pako**-Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës “Nëna Terezë”.

Drejtoreshë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Kimete Kuka Hasallari

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENTE

Aktivitetet nga Sektori i shërbimeve publike :

Aktivitetet nga Sektori i Shërbimeve Publike		Viti	Viti	
Nr		2021	2022	Dif
1	Leje për kyqe në ujësjellës dhe kanalizim	11	07	-4
2	Aktvendime për derdhjen e ujit në hapësira publike	00	00	00
3	Kërkesa të ndryshme (infrakos, acar, OjQ CLARD, KEDS)	02	10	+8
4	Trajnime të ndryshme për zyrtarët (GIZ, AKK, AME, MMPH, OSBE, FKEE)			6
5	Intervenime për zhbllokimin e kanalizimeve fekale	10	16	+6

6	Intervenime për rregullimin rrjetës së ujësjellësit	03	05	+2
7	Intervenime në spërkatjen e drunjve dekorativ me insekticid	03	00	-3
8	Urdhëresa për pagesën e panove reklamuese	01	03	+2
9	Vendime për kryerjen e pagesave për vazhdim qëndrimin e panove reklamuese të paguara	04	06	+2
10	Vendime për kryerjen e pagesave për vazhdim qëndrimin e panove reklamuese të papaguara	01	02	+01
11	Raste mortore të paguara në vlerë prej <u>4,080.00€</u>	20	24	+4
12	Numri i daljeve dhe Intervenimeve emergjente			18
13	Përgjigje në Ankesë	0	3	+3
14	Leje për Taksi			02
15	Intervenime në rregullimin e shenjave të komunikacionit dhe të emërimit të rrugëve			8
16	Përgjigje në Rekomandime	2	1	-1
17	Pastrimin e deponive ilegale të mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi nga NPL Pastrimi Sh.a	6	4	-2
18	Aplikacione në fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë	4	0	-4
19	Numri i inspektimeve në terren për Taxi nga inspektori i Komunikacionit	95	100	+5
20	Numri i taksistëve të regjistruar	7	21	+14
19	Marrëveshja e nënshkruar për shërbime të energjisë me fondin për eficiencë të Energjisë (renovimi i ngrohjes qendrore të shkollës fillore “Ilaz Thaçi”, në vlerë prej 35,361.12 €			
20	Kontraktimin e kompanisë për mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik dhe fekal në vlerë prej 9,804.00 €			
21	Plotësimin e performancës komunale për treguesit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike			
22	Aktivitetet e ndërmarra për festat lokale ,pastrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, mirëmbajtjen e flamujve kombëtar dhe punë të tjera të specifikuar në Marrëveshjen në mes komunës dhe kompanisë NPL Pastrimi sh.a në vlerë prej 40,882.60 €, me nr. protokoli 02/9009/2021 të datës 19.11.202119.11.2022			
23	Aktivitetet e ndërmarra për 11 Qershorin - Ditën e Çlirimit ,			
24	Mirëmbajtjen e rregullt të ndriçimit publik në zonat urbane dhe rurale në vlerë <u>8,882.50 €</u>			

25	Përgatitjen e paramasës për tenderim për shtrirjen e ndriçimit publik në zonën urbane dhe rurale në vlerë prej 5,000.00 € ku tenderi në fjalë është në procedura të ritenderimit për arsye të ofertuesve të cilët ofertojnë jashtë vlerës së parashikuar.
26	Furnizimi dhe montimi i dy reklamava 3D në objektin e Komunës në vlerë prej 1,889.30 €
27	Realizimi i projektit “Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në Han të Elezit” në vlerë prej 5 497.00 €
28	Kontrata e nënshkruar për realizimin e projektit “Vendosja e Tabelës digjitale në rr. Adem Jashari në vlerë prej 18,599.20€, e cila është në proces.
29	Bashkëpunimi me CDI , KRUB , TEUTA për rehabilitimin e ujësjellësit të Dimcës.
30	Takime të rregullta me KFOR-in Polak, Italian, FSK, AME, Policinë e Kosovës, etj
31	Inspektimet e rregullta të shenjave dhe taksive nga inspektori i komunikacionit
32	Vendimi për themelimin e grupit punues për revidimin e planit për menaxhimin e mbeturinave 2022-2027

Vlera e inkasuar për këtë gjashtëmuajor nga sektori i shërbimeve publike dhe komunikacionit për vitin 2021 është :-	2,260.00 €	Diferenca 2021-2022
Vlera e inkasuar për këtë gjashtëmuajor nga sektori i shërbimeve publike dhe komunikacionit për vitin 2022 është :-	5496.70 €	
Pagesa për regjistrimin e autotakxive	615.00 €	
Totali i të hyrave për periudhën Janar-Qershor 2022 është	6,111.70 €	3,851.70€ më shumë

Aktivitetet nga sektori i Komunikacionit:

- Këto gjashtë muaj të parë ka pas inspektime të vazhdueshme në zonën kufitare ku janë inspektuar taksistët dhe është bërë ndjekja e taksistëve ilegal që operojnë në atë pjesë, numri Inspektimeve për këto gjashtë muaj është afro mbi 100 inspektime, po ashtu ka pas dhe inspektime së bashku me inspektorët e tjerë në fushat tjera duke përfshirë ambientin dhe tregtinë, numri i inspektime për këtë 6 mujorësh ka qenë mbi 100. Gjatë kësaj periudhe, inspektori i komunikacionit është angazhuar dhe si mbikëqyrës i dy kontratave:
 - 1) Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në Komunën e Hani të Elezit dhe
 - 2) Shërbimet e mirëmbajtjes së ndriçimit publik në zonat urbane dhe rurale në Han të Elezit. Gjatë kësaj periudhe kemi bërë dhe rregullimin e disa shenjave të dëmtuara.
- Për këtë gjashtëmuajorësh kemi të regjistruar 21 taksistë dhe një operatore që operon në linjat Gorancë – Rezhancë – Hani i Elezit dhe anasjelltas.
- Përveç fushës së komunikacionit, inspektori i komunikacionit merret edhe me regjistrimin e pasurisë, të cilën e ushtron si detyrë shtesë me vendim të Kryetarit, po ashtu gjatë kësaj periudhe janë ndjekur edhe

disa trajnime ku edhe kam përfunduar trajnimin për pozitën zyrtare, e cila iu është dhënë me vendim si zyrtarë i Nën-Alokimeve për Arsimit dhe Shëndetësi.

Aktivitetet nga Inspektori i Ndërtimit:

Raport për muajin **Janar –Qershor** mbi punën në terren dhe inspektimet e punës, të cilat janë duke u kryer nga data: **01.01.2022 deri 31.06.2022**

Bazuar nga inspektimet në terren, varësisht nga natyra e punës si Inspektori i Ndërtimit, në tabelën e më poshtme kam paraqitur numrin e aktiviteteve të bëra sipas natyrës së punës, me ç'rast kam lëshuar: edhe procesverbale për ndërprerje të ndërtimeve pa leje Komunale të lëshuar nga organet kompetente deri në plotësimin e dokumentacionit, ku disa prej tyre kanë bërë kërkesë për leje ndërtimore dhe janë pajisur me leje ndërtimore nga Drejtoria e Urbanizmit.

	AKTIVITETET	Numri i lëndëve
1	Vërejtje me shkrim për ndërtimet në terren, me gojë dhe me shkrim.	asnjë
2	Procesverbale	3 (tre)
3	Vendim për ndertime pa leje	1 (nji)
4	Urdhëresë	1 (nji)
5	Inspektime të punimeve në terren.	20 (inspektime)
6	Përgjigje në kërkesë	1 (nji)
7	Lista e lejeve ndërtimore	2 (dy)
8	Asistencë Policore	

Aktivitetet nga sektori i Emergjencave

- Në tabelarin e mëposhtëm gjeni të bashkangjitur rastet e intervenimeve nga NJZPSH-për periudhën Janar –Qershor 2022 për rastet emergjente.
- Gjatë kësaj periudhe, rastet e zjarreve kanë qenë në fshatin Paldenicë-Ramuk, Pustenik, Dërmjak, lagja Brava-Meliq, lagjja e Kashanit, dhe këto zjarre janë shkaktuar nga faktori njeri dhe nga pa kujdesia.
- Gjatë intervenimeve, përveç njësitit të zjarrfikësve në Han të Elezit kanë qenë të pranishëm edhe policia e stacionit policor në Han të Elezit.
- Njësi i zjarrfikësve, përveç intervenimeve në shuarjen e zjarreve ka marrë pjesë edhe në kryerjen e shërbimeve të tjera, si: aksidente të komunikacionit, shërbime të ndryshme të kërkuara nga Drejtoria e DSHPE-së, skenar të paraqitur nga fabrika SharrCem, etj.

2022								Të lënduar	Të vdekur
------	--	--	--	--	--	--	--	------------	-----------

	Nr. i daljeve	Nr. i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr. i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Tërejsh	zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot
Janar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shkurt	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mars	10	10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Prill	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Maj	7	4	0	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0
Qershor	2	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0
Korrik													
Gusht													
Shtator													
Tetor													
Nëntor													
Dhjetor													
Gjithsej	22	18	0	1	2	0	1	0	0	0	0	0	0

Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjente

Arsim Dernjani

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 kemi pasur disa aktivitete, duke filluar prej muajit Janar deri në muajin Qershor 2022 , e ata janë:

- Kemi pasur konfiskime të drunjve me një sasi prej 61.8 m³, të gjitha janë shkarkuar në depo të komunës dhe janë bërë fletëparaqitje për në gjykatë.
- Nga rojtarët e pyjeve janë dorëzuar 136 fletëparaqitje, 122 fletëparaqitje kundërvajtje dhe 14 fletëparaqitje penale, me një masë drusore prej 115.92m³ dhe në dëmin e llogaritur prej 16,127.11 €.

Paraqesim në formë tabelore krahasimin e fletëparaqitjeve të vitit të kaluar (2021) me periudhën e njëjtë të vitit 2022

Viti	2021	2022
Fletëparaqitje penale	5	14
Fletëparaqitje kundërvajtje	73	122
Gjithsej	78	136

- Pyjet private: Në pyjet private kemi pranuar 17 kërkesa për prerje të drunjve në territorin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022, të gjitha kërkesat kanë qenë të dorëzuara në afat deri më 31 Mars, ku është e paraparë me ligj.
- Vendimet Gjyqësore: Nga Gjykata kemi pranuar 72 vendime, prej tyre 67 vendime pozitive, 4 vendime parashkrim dhe 1 vendim qortim.
- Të hyrat nga APK-ja për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 kanë qenë 257.00€
- Kërkesa për ndërrim-destinimin e pronave private kanë qenë 2 kërkesa,
- Thirrje publike për furnizim të lirë të qytetarëve me drunj për ngrohje nga pyjet publike nga data 21/06/2022 deri më 05/07/2022.
- Subvencionet: janë kryer vetëm për subvencione direkt nga Ministria ku kanë aplikuar 92 fermer (101 fermer në vitin 2021).
- Kemi formuar 4 komisione:
 1. Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për prerje të drunjve në pyjet private.
 2. Komisionin për regjistrimin e dëmeve pyjore.
 3. Komisionin për dëmet e shkaktuara nga ariu.
 4. Komisionin për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

-Kam dorëzuar në MBPZHR-në projektin për ndërtimin dhe rehabilitimin e kanalit të ujitjes „Lloka” më 10/06/2022, me L=253m dhe vlerë 14,719.50€.

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Gjatë periudhës **Janar-Qershor** të vitit kalendarik 2022, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka marrë pjesë në të gjitha takimet, konferencat dhe punëtoritë që i përkasin sferës së zhvillimit ekonomik dhe atij turistik me interes për Komunën e Hanit të Elezit.

Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria poashtu ka qenë urë bashkëpunimi me Ministrinë përkatëse për projekte të caktuara, Ambasada dhe Organizata të ndryshme dhe ka marrë pjesë në grupet punuese për hartimin e disa projekteve me interes komunal. Disa nga këto bashkëpunime janë:

Emri	Projekti	Përshkrimi
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	“Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Pustenik, Gorancë, Dërmjak, Rezhancë, Krivenik”	Në kuadër të “Programi për mbështetje për projektet infrastrukturore për komunitete në komunat e Republikës së Kosovës”, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka aplikuar me projektin e cekur, ku nga ky grant ka qenë përfitues me shumë 30,000.00€ nga vlera totale e projektit e cila është 70,000.00€.
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	“Komunat për të Rinjtë” M4Y	Program nga i cili kanë përfituar 5 projekte nga të rinjtë dhe të reja nga Komuna e Hanit të Elezit vlera e të cilit arrin shumën 24,593.10 €.

Poashtu, Drejtoria ka marrë pjesë edhe në hartimin e disa projekteve kyçe për zhvillim si lloj bashkëpunimi me Drejtorinë e tjera. Ata përfshijnë:

1. Hartimi i projektit “Vendosja e tabelave digjitale në rrugën ‘Adem Jashari’ ”, ku i njëjti është dorëzuar në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal tek “Programi Për Zhvillimin Rajonal”.
2. Pjesë e grupit punues për hartimin e projektit “Parku i Qytetit” në rrugën “Isa Berisha”, vlera e të cilit arrin në shumë prej 200,000.00 €.
3. Projekti “Ndërtimi i aneksit për këmbësorë tek ura në fshatin Seçishtë”.
4. Projekt propozimi “Zbukurimi me drita i xhamive të Komunës”
5. Projekt propozime për:
 - Tabelat Digjitale në shkolla
 - Inventarizimi i çerdhes
 - Ekranë digjitale për Qendrën e Kulturës
 - Invertar për Qendrën e Kulturës

Gjatë këtij gjashtëmuji të parë, është organizuar edhe një punëtori në bashkëpunim me AZhR-Lindje rreth mënyrës së aplikimit në grante individuale, përkatësisht ato që MZhR-ja ndan, ku të pranishëm ishin qytetarë që punojnë kryesisht në sektorin privat dhe ata që dëshirojnë të investojnë në një biznes të ri.

Sektori për Regjistrim të Bizneseve

□ Aplikime për biznese të reja

Përshkrimi	Lloji	Numri	Totali 2021	Totali 2022	Gjinia
Regjistrim biznesi	Biznese individuale / B.I	23	13 B.I	10 B.I	15. M
Regjistrim biznesi	Biznese “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara” / SH.P.K	12	6 Shpk	6 SHPK	1. F

• Aplikime për shuarje të bizneseve

Përshkrimi	Lloji	Numri	Totali 2021	Totali 2022	Gjinia
Shuarje të bizneseve	Biznese individuale / B.I	9	2	7	6 M
Shuarje të bizneseve	Biznese “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara” / SH.P.K	0	0	0	1 F

• Aplikime për ndryshime në biznes

Përshkrimi i shërbimit	Totali
Kërkesë për informata	14
Kërkesë për ndryshimin e pronarëve / aksionarëve	5
Kërkesë për shtimin apo heqjen e aktivitetit	5
Kërkesë për ndryshim të adresës	1

Kërkesë për ndryshimin e drejtorit apo përfaqësuesit të autorizuar	2
Kërkesë për ndryshim të emrit tregtar	3
Kërkesë për ndryshim të bordit	0
Kërkesë për shuarje të njësisë	0
Kërkesë për certifikatë dublikat	4

Inspektoriati i Tregtisë

<u>Inspektimet e bëra gjatë periudhës Janar-Qershor 2022</u>	<u>60</u>
2 Gjoha të shqyrtuara	1,000 €
Aktvendimet dhe shpërndarja e tyre subjekteve aktive	220
Faturat e lëshuara gjatë vitit 2022	50
Faturimi për vitin 2022	81,336.88 €
Inkasimi për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2022	13,120.78 €
<u>Përqindja e inkasimit për gjashtëmuajorin e parë 2022</u>	<u>15 %</u>

Përshkrimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca	%
JANAR	290.00	3,691.00 €	3,401.00	(92.14)
€		€		
SHKURT	1,666.10	435.00 €	1,231.10	283.01
€		€		
MARS	2,471.20	93.00 €	2,378.20	2,557.20
€		€		
PRILL	656.00	40,440.00 €	39,784.00	(0.98)
€		€		
MAJ	156.00	7,052.80 €	6,896.80	(97.79)
€		€		
QERSHOR	6,881.48	4,613.53 €	1,338.55	29.01
€		€		
Totali	12,120.78	56,325.33 €	44,204.55	78.48
€		€		%

Gjobat 1,000.00
€

<u>Totali</u>	<u>13,120.78 €</u>
----------------------	---------------------------

	<u>2022</u>	<u>2021</u>	<u>Diferenca</u>	
Totali i të hyrave	13,120.78 €	56,325.33 €	43,204.55 €	-76.7 %

Drejtoreshë e Zhvillimit Ekonomik

Majlinda Kaloshi